



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 12 regjistër (JR)
Datë 03.03.2021

Nr. 37 i vendimit
Datë 24.11.2021

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Rezarta Schuetz	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 24.11.2021, ditën e martë, në orën 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI I ANKIMIT: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 324, datë 11.12.2020, për subjektin e rivlerësimit Sokol Ngresi, me funksionin gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e Komisionerit Publik Florian Ballhysa të paraqitura në ankim, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 324, datë 11.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Sokol Ngresi, prapësimet e subjektit të rivlerësimit, i cili kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit, dëgjoi gjyqtaren relatore Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Sokol Ngresi ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Apelit Vlorë dhe, për shkak të këtij funksioni, bazuar në parashikimet e nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit kalimtar të rivlerësimit *ex-officio*.
2. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), për subjektin e rivlerësimit, në zbatim të neneve 33, 34 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).
 - 2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar¹, duke konstatuar se: i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin; ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
 - 2.2 DSIK-ja i ka përcjellë Komisionit raportin e kontrollit të figurës², duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.
 - 2.3 KLGj-ja, për subjektin e rivlerësimit Sokol Ngresi, i ka përcjellë Komisionit një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për aftësitë profesionale.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, me vendimin nr. 324, datë 11.12.2020, në bazë të germës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikave 1 dhe 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Sokol Ngresi, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë. Këtë vendim, Komisioni e ka mbështetur mbi konkluzionet e arritura lidhur me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, për të cilat ka konkluduar se:
 - 3.1 **Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:** [...] Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, vërehet se subjekti ka deklaruar saktë pasurinë dhe nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë prej tij. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme. Pas verifikimit, deklarimet e subjektit rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin. Trupi gjykues arsyeton se balancat negative të rezultuara nga analiza financiare e pasurive dhe e shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit, bazuar në analizën e përditësuar financiare [...], nuk është e një shkalle të tillë që të cenojë besimin e publikut. Vetë natyra e analizës financiare mund të paraqesë një shkallë të caktuar pasaktësie në elementet që vlerëson. Ajo thjesht shërben si një tregues i të ardhurave të ligjshme, pasurive dhe shpenzimeve të jetesës për një periudhë kohe. Çdo analizë financiare, nga natyra e saj, është e përafërt dhe jo absolute. Trupi gjykues konsideron se çdo mospërputhje në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet e jetesës së subjektit të rivlerësimit, është pasqyrim i analizës financiare të Komisionit. Si të tilla,

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 25.06.2018.

² Raport i deklasifikuar plotësisht nga ky organ me vendimin e KDZH-së nr. {***}, datë 28.02.2020.

³ Me shkresën nr. {***}, datë 27.12.2019.

mospërputhjet nuk arrijnë nivelin e cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë dhe as nuk ngrenë dyshime mbi mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit. Për këto arsye, trupi gjykues vlerëson se mungesa e këtij likuiditeti nuk përbën arsye për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit nga detyra.

3.2 Për kriterin e kontrollit të figurës: [...] *Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës.*

3.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: [...] *Nga hetimi i thellë administrativ i kryer, nuk u provua asnjë indicie apo element që cenon figurën e gjyqtarit Sokol Ngresi dhe, sipas parashikimeve në nenin 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, propozon për kriterin profesional vlerësimin “i aftë”.*

3.4 Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Ngresi, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;*
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;*
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.*

III. Shkaqet e ankimit

4. Komisioneri Publik Florian Ballhysa ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. 324, datë 11.12.2020, të Komisionit, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Sokol Ngresi. Komisioneri Publik, në pretendimet e parashtruara në ankim, por edhe gjatë seancave gjyqësore publike, ka kundërshtuar vendimin e Komisionit në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, duke kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”) ndryshimin e vendimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

5. Pretendimet e ngritura prej Komisionerit Publik që adresohen vetëm për konkluzionet e Komisionit për kontrollin e pasurisë, në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë.

Për pasurinë apartament banimi me sip. 144,8 m², në {*}, Vlorë,** Komisioneri Publik ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e: **(i)** mungesës së burimeve të ligjshme për të krijuar kursimeve në *cash*, të deklaruara në deklaratën vjetore periodike (në vijim “DPV”) të vitit 2004, për të cilat ka kryer deklarime kontradiktore lidhur me burimin e krijimit dhe pjesën takuese të kursimeve në *cash* (në shumën 18.000 euro), në deklaratat periodike vjetore, procesverbalet e depozituara në ILDKPKI, si dhe ato gjatë hetimit administrativ në Komision; **(ii)** mosdeklarimit në DPV-2007 të kthimit të shumës 17.000 euro; **(iii)** mosdeklarimit në DVP-2009 (në momentin e rikthimit në detyrë dhe rikthimin si subjekt deklarimi) të posedimit të kursimeve në *cash* apo destinacionin e shumës së tërhequr me burim kredinë pranë NBG Bank; **(iv)** mosdeklarimit të pagesës së këstit të fundit prej 7.160 eurosh në DVP-2014 (të cilën e ka deklaruar në DVP -2016), si dhe ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për pagimin e saj; **(v)** mungesë së burimeve të ligjshme në vitin 2015 për pagimin tërësor të shumës së paguar për këstin prej 8.000 eurosh.

5.1 Për pasurinë automjet tip “Skoda Yeti”, me targë {*},** në vlerën 14.500 euro, Komisioneri Publik pretendon se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për blerjen e tij me pagesat e kryera në vitet 2009 e 2010, pasi: **(i)** burimi i financimit të blerjes së këtij automjeti me kursimet në *cash*, nuk mund të konsiderohet, pasi subjekti nuk ka deklaruar pakësim të *cash*-it të viteve të mëparshme; **(ii)** burimi i krijimit me të ardhurat e siguruara prej shitjes së automjetit tip Mercedes-Benz në shumën 7.000 euro, nuk mund të konsiderohet si burim i ligjshëm pasi subjekti, për këto të ardhura, duhet të kishte paguar tatimin për diferencën e vlerës së shitjes me vlerën e zhdoganimit të tij (pasi mjeti është dhuratë prej kushërinjve të tij).

5.2 Për pasurinë, automjet tip “Fiat Panda”, me targë {*},** Komisioneri Publik pretendon që subjekti i rivlerësimit ka pamjaftueshmëri financiare për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet e vitit 2006, përfshirë këtu dhe blerjen e automjetit tip “Mercedes Benz”, me targa {***}, shitja e të cilit ka shërbyer në vijim si një nga burimet e blerjes së automjetit Fiat {***}.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

6. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

b) Legjitimimi i ankuesit

7. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

7.1 Kolegji, në kuptim të *ratione temporis*, mori në shqyrtim pretendimin e ngritur në kundërankim prej subjektit të rivlerësimit⁴, tek i cili, ndër të tjera, ai pretendon se ankimi i Komisionerit Publik është paraqitur jashtë afatit 15-ditor të parashikuar nga neni 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

7.2 Kolegji, referuar akteve të administruara në fashikullin e krijuar nga Komisioni, konstatoi se vendimi objekt shqyrtimi nr. 324, datë 11.12.2020, rezultonte të ishte depozituar pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë më datë 27.01.2021, pasi në këtë ditë rezulton të jetë nënshkruar akti “Njoftim marrje” nga punonjësi përgjegjës i administratës së institucionit.

7.3 Nisur nga fakti i provuar si më lart, llogaritja e afatit të paraqitjes së ankimit të Komisionerit Publik objekt i këtij gjykimi, do të kryhet në raport me datën 27.01.2021. Referuar parashikimit të nenit 3, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: “Ditë” nënkupton ditë kalendarike që llogariten sipas rregullave të përcaktuara në nenin 56 të Kodit të Procedurave Administrative, Kolegji analizoi pretendimin e subjektit sipas normës referuese përkatëse, e cila parashikon se: *kur afati caktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të*

⁴ Në Kolegji, kundërankimi i subjektit të rivlerësimit është regjistruar me nr. {***} prot., datë 03.03.2021.

ecë afati. Në zbatim të këtyre dispozitave dhe në analizë të rrethanave të faktit të përshkruara më lart, Kolegji llogariti afatin prej 15 ditësh, të parashikuar nga neni 63 i ligjit nr. 84/2016, brenda të cilit mund të paraqitet ankimi ndaj një vendimi të Komisionit, duke e filluar numërimin e ditëve nga data 28.01.2021 që i takon së nesërme të datës 27.01.2021, ditë në të cilën vendimi i Komisionit i është komunikuar zyrtarisht Institucionit të Komisionerëve Publikë. Në konkluzion të kësaj analize, rezultoi se ankimi i Komisionerit Publik, i paraqitur në datën 11.02.2021, është brenda këtij afati dhe Komisioneri do të konsiderohet se plotëson kushtin *ratione temporis* në verifikim të këtij elementi të legjitimitimit formal të tij.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

8. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit nr. 324, datë 11.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke qenë se është ushtruar nga Komisioneri Publik, u zhvillua në seancë gjyqësore publike. Përgjatë seancave gjyqësore, Komisioneri Publik, në mbështetje të ankimit të tij, ka kundërshtuar vendimin e Komisionit në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë duke pretenduar se aktet e administruara përgjatë hetimit administrativ, si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, nuk mbështesin konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në drejtim të kontrollit të kriterit të pasurisë. Subjekti i rivlerësimit Sokol Ngresi ka prapësuar pretendimet e Komisionerit Publik duke analizuar në mbështetje të këtyre prapësimeve, provat e paraqitura e të administruara prej Kolegjit përgjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes.
9. Në Kolegj, gjatë gjykimit të kësaj çështjeje, u administruan denoncime nga publiku të depozituara nga denoncuesit S. Sh.⁵, H. L.⁶, B. Sh.⁷ dhe B. M.⁸ dhe Q. H.⁹. Në denoncimin e znj. S. Sh. dhe z. H. L. ngriheshin dyshime për pasuri të paluajtshme të padeklaruar të subjektit të rivlerësimit, të llojit apartament me sip.113,43 m² dhe 92 m² verandë, me vendndodhje tek “{***}” Vlorë, në objektin e ndërtuar nga shoqëria e ndërtimit “{***}” ShPK. Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit me këtë shoqëri ndërtimi kishte pasur një marrëdhënie kontraktuale për porositjen e apartamentit me vendndodhje tek “{***}”, Vlorë. Sipas denoncuesve, kjo marrëdhënie ishte formalizuar në një kontratë porosie¹⁰ dhe, sipas kopjeve të akteve bashkëlidhur denoncimeve, pretendohet se subjekti i rivlerësimit kishte kryer edhe pagimin e disa kësteve të vlerës së apartamentit, pasuri e cila nuk rezultonte të ishte deklaruar në deklaratat periodike të pasurisë dhe as në atë *vetting*.

9.1 Subjekti i rivlerësimit i kundërshtoi të dhënat e bëra prezente në denoncimin e denoncueseve S. Sh.¹¹ e H. L.¹², duke pretenduar se ishin tërësisht të pavërteta dhe të rreme, të paraqitura me qëllim cenimin e procesit të tij të rivlerësimit, dhe se aktet bashkëlidhur këtyre denoncimeve ishin të falsifikuara.

⁵ I protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot. dhe nr. {***} prot., datë 02.07.2021.

⁶ I protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 09.07.2021.

⁷ I protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 09.07.2021.

⁸ I protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 22.10.2021, i nënshkruar në emër të denoncuesit B. M. nga avokat A. B..

⁹ Ky shtetas ka paraqitur në Kolegj dy denoncime të protokolluara me nr. {***} prot., datë 05.11.2021 dhe nr. {***} prot., datë 05.11.2021.

¹⁰ Me nr. {***} rep., datë 26.02.2014 dhe mandat arkëtimet nr. {***}, datë 26.02.2014, nr. {***}, datë 27.05.2014 dhe nr. {***}, datë 29.09.2014.

¹¹ I protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot. dhe nr. {***} prot., datë 02.07.2021.

¹² I protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 09.07.2021.

9.2 Kolegji, pasi analizoi informacionin dhe aktet shoqëruese të këtyre denoncimeve të administruara pasi kishte nisur gjykimi i çështjes, vlerësoi se denoncimi i znj. S. Sh. dhe z. H. L. përmbanin të dhëna që duheshin verifikuar në kuptim të kriterëve të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016. Për këtë arsye, vendosi¹³ që këto denoncime t'ia nënshtrojë hetimit gjyqësor. Për këtë arsye, me qëllim hetimin e plotë të tyre, Kolegji vendosi kryerjen e disa veprimeve hetimore që u konsideruan të nevojshme për verifikimin e tyre.

9.3 Kolegji gjithashtu vlerësoi edhe pretendimet e ngritura në denoncimin e shtetasit B. M., B. Sh. dhe Q. H., të cilët, në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, nuk rezultuan të kishin të dhëna që mund të afektonin procesin e rivlerësimit për subjektin dhe, për pasojë, të ndryshonin vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga Kolegji

i. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

10. *Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit për pasurinë nr. 1, apartament banimi me sip. 144,8 m², në {***}, Vlorë, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e: (i) mungesës së burimeve të ligjshme për të krijuar kursimeve në cash, të deklaruar në DPV-2004, për të cilat ka kryer deklarime kontradiktore lidhur me burimin e krijimit dhe pjesën takuese të kursimeve në cash (në shumën 18.000 euro), në deklaratat periodike vjetore, procesverbalet e depozituara në ILDKPKI, si dhe ato gjatë hetimit administrativ në Komision; (ii) deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në DPV-2007 si gjendje cash të kthimit të shumës 17.000 euro (kësti i parë i ap. 84 m²); (iii) mosdeklarimit në DPV-2009 (në momentin e rikthimit në detyrë dhe rikthim si subjekt deklarimi) të posedimit të kursimeve në cash apo destinacionin e shumës së tërhequr me burim kredinë pranë NBG Bank; (iv) mosdeklarimit të pagesës së këstit të fundit prej 7.160 eurosh në DPV-2014 (të cilën e ka deklaruar në DPV-2016), si dhe ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për pagimin e saj; (v) mungesës së burimeve të ligjshme në vitin 2015, për pagimin tërësor të shumës së paguar për këstin prej 8.000 eurosh, Kolegji mori në shqyrtim rrethanat e mëposhtme.*

10.1 Komisioni, në hetimin administrativ për pasurinë apartament 144,8 m² në Vlorë, është përqendruar në kontrollin e burimeve të financimit të përdorura për blerjen e saj, për të cilën ka konkluduar se:

Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar në dosje dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se subjekti në deklaratën vetting ka deklaruar saktë dhe me vërtetësi pasurinë apartament në Vlorë. Për sa i përket pretendimit të subjektit, në lidhje me standardin e ndjekur nga Komisioni në përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës, qëndron si argument logjik për faktin se bazohen mbi një studim konkret të tregut dhe reflekton realitetin sipas qyteteve, si dhe referon një dokument zyrtar. Por tashmë Komisioni ka një standard të vendosur, i unifikuar për të gjitha subjektet, në të gjithë territorin e vendit, pavarësisht vendbanimit të tyre. Në vijim të këtij argumenti, Komisioni argumenton se balanca negative e rezultuar nga analiza financiare për subjektin, nuk është në atë masë sa subjekti të konsiderohet fajtor dhe, për pasojë, të passjellë aplikimin e një mase disiplinore. Përfundimisht u konkludua se subjekti në deklaratën vetting ka deklaruar saktë dhe me vërtetësi pasurinë apartament, ka shpjeguar bindshëm burimet e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

10.2 Nga aktet e administruara përgjatë hetimit administrativ, rezulton se subjekti i rivlerësimit për apartamentin e banimit me sip. 144,8 m², të ndodhur në {***}, Vlorë, në deklaratën e pasurisë

¹³ Me vendim të ndërmjetëm në seancën gjyqësore të datës 07.07.2021.

vetting ka deklaruar se është lidhur me shoqërinë ndërtuese “{***}” ShPK, kontrata e porosisë¹⁴ më datë 13.11.2012 dhe kontrata e shitblerjes¹⁵ më datë 23.03.2015. Referuar kontratës së shitblerjes, çmimi i blerjes së kësaj pasurie rezulton të jetë 65.160 euro. Si burime të financimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kanë shërbyer: **(i)** kredia e marrë nga Raiffeisen Bank në shumën 30.000 euro; **(ii)** kredia e marrë nga NBG në shumën 16.000 euro; si dhe **(iii)** kursimet e grumbulluara në vite, në shumën 19.160 euro.

10.3 Për sa u përket burimeve të deklaruara se janë përdorur për financimin e kësaj pasurie ndër vite, rezulton se në DPV-2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se burimet e financimit të apartamentit me sip.144,8 m², të ndodhur në {***}, Vlorë, të porositur në këtë vit prej tij, janë: **(i)** kredi nga Raiffeisen Bank, në shumën 30.000 euro; **(ii)** kursime të grumbulluara në vite, në shumën 20.000 euro. Në DPV-2015, subjekti ka deklaruar pagimin e këstit të radhës për këtë pasuri në vlerën 8000 euro, me burim 4000 euro nga kursimet e këtij viti dhe 4000 euro nga kursimet e mëparshme. Në DPV-2016, subjekti ka deklaruar pagimin e këstit të fundit me vlerë 7160 euro, me burim nga kursimet e vitit dhe nga kursimet e mëparshme. Në kontratën e shitblerjes të vitit 2015, është shprehur se vlera totale e këtij apartamenti është 65.160 euro dhe palët kanë deklaruar se shuma e blerjes është likuiduar jashtë zyrës noteriale me këste, sipas dokumenteve bashkëlidhur kontratës, të renditura si vijojnë.

- Mandatarkëtimi nr. {***}, datë 14.11.2012, me përshkrimin: *Arkëtuar nga Sokol dhe L. Ngresi shuma prej 20.000 eurosh, për prenotim apartamenti me sip. 144 m².*
- Dokument njoftim debitimi me urdhëruese znj. L. N.¹⁶, datë 27.12.2012, me detaje pagese: *kalim fondi për blerje apartamenti, në shumën 30.000 euro, me përfitues shoqëria “{***}” ShPK.*
- Mandatarkëtimi nr. {***}, datë 18.12.2014, me përshkrimin: *Arkëtuar nga z. Sokol Ngresi shuma prej 7.160 eurosh, për likuidim apartamenti.*
- Mandatarkëtimi nr. {***}, datë 22.02.2015, me përshkrimin: *Arkëtuar nga z. Sokol Ngresi shuma prej 8.000 eurosh, për likuidim apartamenti.*

10.4 Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të krijuar kursimet në *cash* të deklaruara në DPV-2004, në shumën prej 18.000 eurosh, për të cilat ka kryer deklarime kontradiktore lidhur me burimin e krijimit dhe pjesën takuese, si: në deklaratat periodike vjetore, në procesverbalet e depozituara në ILDKPKI, si dhe në ato gjatë hetimit administrativ në Komision, Kolegji i analizoi të gjitha deklaratimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me to në harmoni dhe duke i krahasuar me njëra-tjetrën, nën optikën e legjislacionit të zbatueshëm.

10.5 Për t’i dhënë përgjigje këtij shkaku ankimi, Kolegji mori fillimisht në analizë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me gjendjen e *cash*-it të dekluar prej tij në deklaratën periodike të vitit 2004, në të cilën ai deklaroi për herë të parë pasuri të llojit likuiditet në gjendje *cash*, në vlerën prej 18.000 eurosh. Ndërsa rezulton se në deklaratën fillestare të deklaratimit të pasurisë të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime në *cash*, në DPV-2004, ai ka deklaruar pasurinë likuiditet në *gjendje cash, në vlerën 18.000 euro, me pjesë takuese 1/2*, me përshkrimin: *Kursime nga paga ime dhe bashkëshortja nga 09.02.1996 e në vazhdim.*

¹⁴ Nr. {***} rep., datë 13.11.2012.

¹⁵ Nr. {***} rep., nr. {***} kol., me palë shitëse shoqërinë ndërtuese “{***}” ShPK.

¹⁶ Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit.

10.6 Nga këto deklaramë, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në që i përket vitit 2004¹⁷, zotërimin e një shume në *cash*, në vlerë prej 18.000 eurosh, duke deklaruar njëkohësisht se burimi i krijimit të kësaj shume janë pagat e tij dhe të bashkëshortes së tij që nga viti 1996 e në vazhdim, pra përfshirë edhe vitin 2004, kur bëhet deklarimi. Krahas këtij fakti, ai ka përcaktuar se pjesa takuese mbi këtë pasuri është sa ½ e saj. Komisioneri Publik në ankim e trajton këtë kursim si një vlerë të krijuar vetëm përgjatë vitit 2004, duke u mbështetur mbi faktin se ajo është deklaruar për herë të parë në këtë vit dhe, për pasojë, do të duhet të konsiderohet se është pasuri e krijuar brenda këtij viti kalendarik. Duke e konsideruar në këtë mënyrë burimin e krijimit të kësaj pasurie, Komisioneri Publik i ka rezultuar se subjekti nuk kishte të ardhura të mjaftueshme për ta krijuar atë dhe, për pasojë, sipas pretendimit të tij, ai rezulton në mungesë të burimeve të ligjshme për këtë vit, në shumën prej 1.357.384 lekësh.

10.7 Kolegji analizoi, krahas deklaramëve të subjektit në DPV-në që i përket vitit 2004, edhe shpjegimet që ai ka dhënë gjatë hetimit administrativ për këtë çështje kur është pyetur nga Komisioni, me atë të cilave është shprehur se: *[...] vlera prej 18.000 eurosh CASH, e pasqyruar, nuk është tërësisht vlera e kursimeve të mia dhe bashkëshortes sime. Siç kam shënuar në rubrikën "Pjesa që zotëron në %, sasi apo vlerë", zotëroj 1/2 e kësaj vlere dhe këtu kam pasur parasysh që vlera prej 9.000 eurosh është gjendja CASH në bashkëpronësinë time dhe të bashkëshortes, ndërsa pjesa tjetër ka qenë gjendje CASH e një pjese të të hollave që prindërit e mi kishin nga kursimet e tyre ndër vite. Në atë periudhë deklarimi, jetoja së bashku me prindërit e mi dhe kam vlerësuar se duhej të deklarohja gjithë vlerën CASH që ndodhej fizikisht në banesën tonë. Pra, unë dhe bashkëshortja ime, më 31.12.2004, nga 18.000 euro që gjendeshin fizikisht CASH në banesë, kishim së bashku në bashkëpronësi vetëm 9.000 euro, e krijuar me të ardhurat tona nga pagat ndër vite.*

Në sqarimin e dhënë pranë ILDKPKI-së, që është protokolluar në datën 26.3.2007¹⁸, kam sqaruar se disa kohë pas lidhjes së kontratës së prenotimit të apartamentit në vitin 2003, kjo kontratë është zgjidhur me vullnet të të dy palëve dhe vlera e parapaguar prej 6.000 eurosh përfshihet në shumën 18.000 euro CASH që gjendej në banesë, nga të cilat, siç theksova edhe më lart, vetëm 1/2 e saj, pra 9.000 euro ishin në bashkëpronësinë time dhe bashkëshortes sime.

10.8 Në konsideratë të pretendimeve të Komisionerit Publik mbi këtë pasuri, si edhe të gjitha deklaramëve që ka bërë subjekti i rivlerësimit rreth saj në deklaratat periodike vjetore, por edhe në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, Kolegji çmon se dy ishin alternativat e vlerësimit të këtyre deklaramëve dhe analizës që mund t'u bëhej burimeve të subjektit për të krijuar këtë shumë. Sipas alternativës së parë, u verifikua mundësia e krijimit të shumës prej 18.000 eurosh nga subjekti dhe bashkëshortja në vitet e përcaktuara prej tij, duke konsideruar se ½ pjesë e deklaruar prej tij në DPV-në e vitit 2004, i takonte atij së bashku me bashkëshorten sipas shpjegimeve që ai ka dhënë gjatë hetimit, ndërsa sipas alternativës së dytë, u verifikuan mundësitë financiare të subjektit për të krijuar me burime të ligjshme të gjithë shumën prej 18.000 eurosh nga viti 1996 deri në vitin 2004, duke e interpretuar deklarimin për ½ pjesë se i përkiste atij si bashkëshort brenda bashkësisë ligjore. Në të dyja alternativat, Kolegji çmon të konsiderojë të plotë deklarimin e subjektit në DPV-në e vitit 2004 për sa i përket jo vetëm deklarimit për zotërimin e shumës prej 18.000 eurosh, por edhe burimit të krijimit të saj prej vitit 1996 deri në vitin 2004 me të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes së tij, sepse nuk e gjen të drejtë leximin/interpretimin që

¹⁷ Subjekti i rivlerësimit më parë kishte plotësuar deklaratën fillestare të deklarimit të pasurisë, e cila është dorëzuar prej tij në ILDKPKI më 31 mars 2004 dhe tregon gjendjen e pasurisë së tij deri më 31.12.2003. Ndërsa me deklaratën vijuese periodike që i përket vitit 2004, e cila dorëzohej pranë ILDKPKI-së brenda datës 31 mars 2005, kërkohej të evidentoheshin ndryshimet e pasurisë së deklaruesit deri më 31 dhjetorit të vitit 2004.

¹⁸ Subjekti i rivlerësimit, ndër vite, pranë ILDKPKI-së, ka dhënë gjithsej 3 shpjegime të materializuara në procesverbale, përkatësisht në vitin 2007, në vitin 2011 dhe në vitin 2014.

Komisioneri Publik i bën këtij deklarami, duke e konsideruar si të vlefshëm vetëm për sa i përket shumës prej 18.000 eurosh dhe jo kohës së krijimit të saj. Trupi gjykues e gjen të drejtë të konsiderojë se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në vitin 2004 disa elemente në lidhje me këtë pasuri, të cilat duhet të lexohen e vlerësohen në mënyrë integrale dhe duke përcaktuar si të rëndësishme vlerën provuese të DPV-2004 lidhur me këtë pretendim, në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pavarësisht faktit se nuk ka bërë deklarime në lidhje me pasurinë likuiditet në vitin 2003, mungesë të cilën ai e justifikon me faktin se nuk e ka poseduar gjendjen *cash* në atë vit, duke qenë se kishte paguar shumën prej 6000 eurosh për llogari të pagesës së këstit të parë të prenotimit të një apartamenti¹⁹, dhe faktit se pjesa tjetër ishte në zotërim të prindërve. Nga ky dokument, i cili mund të përdoret si provë në procesin e rivlerësimit, përftohen dy të dhëna, e para që subjekti posedonte në vitin 2004 shumën prej 18.000 eurosh në *cash* dhe se këto ishin krijuar me të ardhurat në vite të tij dhe bashkëshortes, nga viti 1996 deri në vitin 2004.

10.9 Gjithashtu Kolegji konsideroi bindës shpjegimin e subjektit mbi lidhjen e një kontrate porosie për një apartament në vitin 2003 dhe pagesën sipas saj të këstit të parë prej 6000 eurosh, fakt i deklaruar në deklaratën fillestare të pasurisë në vitin 2003, si edhe faktin se kjo kontratë është revokuar me marrëveshje të palëve dhe shuma është kthyer mbrapsht te subjekti në vitin 2004. Kjo shumë, ndonëse nuk është deklaruar si e kthyer në deklaratën e vitit 2004, rezulton të jetë deklaruar si e paguar në deklaratën fillestare të pasurisë, në të cilën subjekti ka deklaruar se ka paguar këtë shumë si këst të parë për porositjen e apartamentit në lagjen “{***}”. Ndërsa, përpos sa subjekti ka deklaruar në shpjegimet e tij²⁰ për prishjen e kontratës me shoqërinë “{***}” ShPK, në kontratën e lidhur mes tyre në datën 13.03.2004 është bërë shënimi në datën 12.11.2004 se palët deklarojnë zgjidhjen e kontratës dhe kthimin e shumës prej 6000 eurosh subjektit dhe se nuk kanë asnjë detyrim ndaj njëri-tjetrit. Ky deklaram është në harmoni edhe me faktin e mosdeklarimit të asnjë detyrimi ndaj personave fizikë apo juridikë në DVP-2004, e dhënë që tregon se nuk ekzistonte më një marrëdhënie e subjektit me shoqërinë ndërtuese. Nga hetimi i kryer nga Komisioni, nuk ka rezultuar asnjë e dhënë që të tregojë apo të krijojë dyshime se subjekti i rivlerësimi ka ndonjë të drejtë mbi këtë pasuri, të dhëna që mund të kishin vënë në dyshim deklaramet e tij për zgjidhjen e kontratës, por edhe përfitimin mbrapsht të shumës prej 6000 eurosh. Sipas kontratës, rezulton se ajo është zgjidhur brenda vitit 2004, duke bërë të mundur në këtë mënyrë, përfshirjen e kësaj shume në likuiditetet e këtij viti. Gjithashtu, nga këqyrja e leximi i deklaratës së vitit 2004, në rubrikën ku është shënuar gjendja *cash*, e cila është shkruar mbi një shënim të fshirë që lidhet me apartamentin e porositur²¹, duket se jepet informacion për dilemën dhe përpjekjen e pretenduar të subjektit për të pasqyruar në një mënyrë lidhjen e shumës së kthyer nga revokimi i kontratës, me gjendje *cash* të krijuar atë vit.

10.10 Përveç sa më sipër, subjekti është i besueshëm në këtë shpjegim edhe për faktin se ai është gjendur në një situatë të ngjashme edhe më pas, duke demonstruar se ka qenë në një proces kërkimi për blerjen e një apartamenti banimi, i cili nuk është finalizuar edhe në një rast tjetër, me shoqërinë “{***}” ShPK, derisa subjekti ka lidhur kontratën me shoqërinë “{***}” ShPK në vitin 2012 për blerjen e apartamentit në të cilin banon, të ndodhur në lagjen “{***}”, në Vlorë. Ndonëse jo me vlerë të plotë provuese, për shkak të formës dhe procedurës së administrimit të dokumentit “Sqarim” të datës 26.03.2007, nënshkruar prej subjektit të rivlerësimit dhe depozituar në ILDKPKI, dhe përcjellë prej këtij të fundit në Komision me shkresën nr. {***}, datë 29.05.2020, deklaramet e njëjta të subjektit të rivlerësimit të pasqyruara në këtë akt, vlerësohen si indicie që japin një informacion në këtë nivel provueshmërie, por që të analizuara në harmoni me të dhënat

¹⁹ Sipas kontratës së lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK më datë 13.03.2004

²⁰ Këto shpjegime janë dhënë nga subjekti i rivlerësimit për pyetëtorin e Komisionit të datës 02.12.2019, bashkëlidhur të cilave ka paraqitur si provë edhe kontratën me shoqërinë “{***}” ShPK.

²¹ Në qelizën ku është shënuar gjendja *cash*, rezulton të jetë fshirë shënimi “prenotim i apartamentit 2+1”.

që u përshkruan më lart e që rezultojnë nga hetimi, duket se vijnë në harmoni e u japin besueshmëri deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të përfitimit të shumës prej 6.000 eurosh me zgjidhjen e kontratës së porosisë. Së fundmi, vlen të përmendet edhe se Komisioneri Publik në ngritjen e pretendimit të tij mbi analizën financiare për shumën prej 18.000 eurosh, e konsideron të kthyer te subjekti shumën prej 6.000 eurosh, por llogarit si burim krijimi të kësaj shume vetëm të ardhurat e krijuara përgjatë vitit 2004 e të deklaruara në DPV-në e këtij viti, duke konkluduar në këtë mënyrë për një diferencë negative në vlerën prej (-)1.357.384 lekësh.

10.11 Mbi këto të dhëna, Kolegji analizoi mundësinë e krijimit të shumës prej 18.000 eurosh në dy alternativa, të cilat lidhen me pjesën takuese të subjektit në to.

- Sipas alternativës së parë, Kolegji verifikoi mundësinë e krijimit të shumës prej 18.000 eurosh nga subjekti dhe bashkëshortja në vitet e përcaktuara prej tij, duke konsideruar se ½ pjesë e deklaruar prej tij i takonte atij së bashku me bashkëshorten, sipas shpjegimeve që ai ka dhënë gjatë hetimit. Nga analiza financiare e kryer në Kolegji, rezultoi se subjekti kishte mundësi të justifikonte me burime të ligjshme pjesën e tij prej 9.000 eurosh në vitin 2004, sipas pretendimit se pjesa tjetër prej 9.000 eurosh u takonte prindërve të tij. Në këtë version të analizës, Kolegji kreu një vlerësim të arsyeshëm dhe të logjikshëm edhe për mundësinë e prindërve të subjektit për të krijuar deri në atë vit shumën prej 9.000 eurosh, dhe nga ky vlerësim, rezultoi se edhe ata kishin mundësi financiare të zotëronin shumën prej 9.000 eurosh në vitin 2004²².
- Përveç sa më sipër, Kolegji kreu analizën financiare edhe në versionin tjetër, tek i cili vlerësoi mundësitë financiare të subjektit për të krijuar me burime të ligjshme të gjithë shumën prej 18.000 eurosh nga vitit 1996 deri në fund të vitit 2004, duke përdorur si burim të ardhurat nga puna të tij dhe e bashkëshortes. Edhe në këtë version të analizës financiare, rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte burime të ligjshme për të krijuar këtë pasuri në këtë vit.

10.12 Në përfundim të kësaj analize, Kolegji arriti në konkluzionin se pretendimi i Komisionerit Publik lidhur me faktin se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të krijuar shumën prej 18.000 eurosh në vitin 2004, nuk është i saktë. Pavarësisht deklarimeve jo të plota të subjektit në vitet 2003-2004 për pasurinë likuiditet, nga leximi dhe analiza logjike e deklarimeve të bëra prej tij qoftë në DPV-në e vitit 2004, qoftë në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, në çdo rast, subjekti justifikon me burime të ligjshme pasurinë e deklaruar prej tij edhe në version e pranuar prej Komisionerit Publik se ai zotëron me bashkëshorten të gjithë shumën. Në lidhje me këtë çështje, Kolegji nënvizon qëndrimin e tij të konsoliduar tashmë se pasaktësitë në deklarime periodike të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi²³. Në të kundërt, pasaktësitë e pretenduara në deklarimet periodike nuk mund të shërojnë dhe as të shpjegojnë mungesën e burimeve të ligjshme që rezultojnë nga analiza financiare që bëhet mbështetur mbi këto deklarime, e cila mbetet dhe

²² Sipas dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, prindërit e subjektit të rivlerësimit për periudhën 1991-2004 kanë përfituar pension pleqërie dhe pension suplementar në vlerë totale prej 2.348.335 lekësh. Gjithashtu prindërve të subjektit të rivlerësimit, në këtë periudhë, u është dhuruar nga nusja e djalit (i cili ka rënë në krye të detyrës) shuma prej 1.500.000 lekësh. Shpenzimet për kosto jetese të përllogaritura sipas metodologjisë së Kolegjit, rezultojnë në masën 1.579.788 lekë. Në përfundim, situata financiare e prindërve të subjektit të rivlerësimit në fund të vitit 2004, rezulton në vlera pozitive prej 1.168.547 lekësh, e cila e konvertuar me kursin e këmbimit të fund vitit 2004, është ekuivalente me 9.220 euro.

²³ Shih vendimet e Kolegjit:

[nr. 24/2021 \(JR\) datë 28.07.2021](http://kpa.al/wp-content/uploads/2021/10/Vendimi_L.H._anonimizuar.pdf) - http://kpa.al/wp-content/uploads/2021/10/Vendimi_L.H._anonimizuar.pdf; [nr. 28/2020 \(JR\) datë 23.10.2020](http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/12/Vendimi-F.-V.-i-anonimizuar-varianti-ok.pdf) - <http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/12/Vendimi-F.-V.-i-anonimizuar-varianti-ok.pdf>; [nr. 25/2021 \(JR\) datë 29.07.2021](http://kpa.al/wp-content/uploads/2021/11/Vendim_A.Y._anonimizuar.pdf) - http://kpa.al/wp-content/uploads/2021/11/Vendim_A.Y._anonimizuar.pdf.

konsiderohet si shkak shkarkimi sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

10.13 Pavarësisht konkluzionit të mësipërm dhe analizës shteruese në përgjigje të pretendimeve të Komisionerit Publik, Kolegji konsideroi në analizën vijuese financiare, jo shumë prej 18.000 eurosh si pasuri e subjektit, por vetëm shumë prej 9.000 eurosh, duke qenë se vetë subjekti pretendon se në vitet në vijim ka pasur të mbartur nga ky vit vetëm këtë shumë dhe jo shumë e plotë, ndonëse ky element nuk duket se e favorizon atë në analizën financiare, por u konsiderua në këtë mënyrë, duke qenë se për çdo opsion të analizës financiare, me zotërimin e shumës 18.000 euro apo qoftë me zotërimin e shumës 9.000 euro, subjekti kishte mundësi t’i krijonte ato me burime të ligjshme, duke përmbushur kriterin ligjor të justifikimit të burimit të pasurisë që ai përdor më pas për financimin e pasurive të tjera. Qëndrimi i Kolegjit lidhur me këtë çështje, është gjithashtu në koherencë me deklaratimet e subjektit i cili pretendon se ka mbartur një pasuri me vlerë më të ulët nga sa ai justifikonte ligjërisht dhe, duke qenë se kjo pasuri nuk mund të provohet se ka ekzistuar ndryshe, përveç se me deklaratimet e subjektit, për shkak se ajo nuk gjendet e materializuar në ndonjë formë në kohën respektive, por vetëm në gjendjen *cash* në banesë. Ajo që është e rëndësishme për këtë analizë, sipas vlerësimit të Kolegjit, është fakti se përderisa subjekti justifikon shumë prej 18.000 eurosh në vitin 2004, ai sigurisht që justifikon edhe ½ e saj, të cilën ai pretendon se e ka përdorur si burim financimi për pasuritë që janë krijuar më pas në vite.

10.14 *Në funksion të shkakut të parë të ankimit, Kolegji gjithashtu mori në shqyrtimin pretendimin tjetër të Komisionerit Publik, me anë të të cilit ai parashtron se subjekti i rivlerësimit rezulton të mos ketë deklaruar në DPV-2007, kthimin e shumës 17.000 euro nga shoqëria “{***}” ShPK²⁴.*

10.15 Në vendimin objekt shqyrtimi, pasi arsyetohet se subjekti ka pasur burime të ligjshme për krijimin e shumës 17.000 euro, të cilat i ka përdorur për pagimin e këstit të parë për prenotimin e apartamentit të shoqëria e ndërtimit “{***}” ShPK, nuk bëhet asnjë analizë lidhur me kthimin e kësaj shume subjektit nga kjo kompani pas prishjes së kontratës së porosisë së vitit 2007, por, referuar të dhënave të analizës ekonomike të vendimit, rezulton se kjo shumë është përfshirë si e ardhur në këtë vit dhe nga ky element deduktohet se Komisioni ia ka konsideruar të kthyer subjektit këtë shumë.

10.16 Kolegji konstaton se edhe ky pretendim i Komisionerit Publik lidhet me interpretimin e të dhënave të deklaruara prej subjektit të rivlerësimit në DPV-2007, e cila ka qenë jo vetëm deklarata periodike e pasurisë që i korrespondonte këtij viti, por edhe deklarata në përfundim të funksionit, duke qenë se subjekti për shkak të vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në shkurt të vitit 2008 nuk ka vijuar të ushtrojë funksionin e gjyqtarit, dhe koha e plotësimit të kësaj deklarate ka përkuar me kohën e lënies së detyrës. Pavarësisht se ajo është plotësuar nën formatin e një deklarimi periodik, ka gjithashtu edhe peshën e deklaratimit pas lënies së detyrës të subjektit të rivlerësimit. Nga leximi i kësaj deklarate, rezulton se subjekti ka deklaruar prenotimin e një apartamenti banimi²⁵ prej 84 m², në ndërtim e sipër, të shoqëria “{***}” ShPK, me një vlerë prej 33.000 eurosh, për të cilin ka kryer pagimin e këstit të parë në vlerën 17.000 euro, dhe më pas ka marrë kredi pranë NBB Bank²⁶ në shumë 16.000 euro, me të cilën ka paguar edhe këstin e dytë. Po në DPV-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar prishjen e kontratës së porosisë me shoqërinë “{***}” ShPK dhe kthimin e këstit të dytë të paguar për këtë apartament nga sipërmarrësi, me vlerë 16.000 euro. Në këtë deklaram, subjekti nuk rezulton të ketë bërë deklarime mbi kthimin e

²⁴ Kësti i parë i ap. 84 m² të porositur të shoqëria e ndërtimit “{***}” ShPK.

²⁵ Me kontratë noteriale nr. {***} rep, datë 28.08.2007.

²⁶ Me kontratë kredie nr. {***}, datë 01.10.2007.

shumës tjetër të deklaruar se është paguar prej tij për prenotimin e apartamentit në vlerën prej 17.000 euro. Për shkak të këtyre deklaramëve, Komisioneri Publik pretendon që në analizën financiare për llogaritjen e burimeve të ligjshme për financimin e apartamentit të ndodhur në lagjen “{***}”, të blerë në vitin 2012, të mos përfshihet shuma prej 17.000 eurosh, duke qenë se subjekti nuk ka deklaruar se e ka marrë mbrapsht këtë shumë dhe se kjo shumë nuk justifikohet me burime të ligjshme në vijim të pretendimit të ngritur lidhur me shumën prej 18.000 euro.

10.17 Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, por edhe atij gjyqësor të zhvilluar në Kolegj, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK kontratën e porosisë me nr. {***} rep., datë 28.08.2007, për një apartament banimi. Sipas përmbajtjes së kësaj kontrate, subjekti rezulton se fillimisht i ka paguar shoqërisë shumën prej 17.000 eurosh, sipas mandatar-këtimit nr. {***}, datë 20.08.2007.

10.18 Gjithashtu, nga aktet, rezulton se me disbursimin e kredisë prej 16.000 eurosh, të marrë nga Banka NGB, është paguar nëpërmjet transaksionit bankar, shuma tjetër prej 16.000 eurosh në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, duke shlyer të gjithë vlerën e apartamentit të porositur prej subjektit në shumën prej 33.000 eurosh. Kjo kontratë deklarohet si e zgjidhur nga subjekti i rivlerësimit që në vitin 2007, brenda të njëjtit vit në të cilin ishte lidhur dhe se e gjithë shuma i është kthyer atij mbrapsht, duke qenë se vetë zgjidhja e kontratës nënkupton që palët të kthehen në gjendjen e mëparshme. Në lidhje me mungesën e deklaramit në DPV-në e vitit 2007, të kthimit të gjithë shumës, por vetëm të shumës së marrë kredi, subjekti ka shpjeguar se kjo lidhet me faktin se gjendja *cash* e deklaruar prej tij në vite, për shkak të zgjidhjes së kontratës nuk kishte pësuar ndryshime, 17.000 euro ishin paguar dhe kthyer brenda vitit, dhe vetëm shuma prej 16.000 eurosh, me burim kredinë në NGB, kishte sjellë ndryshim të gjendjes së tij likuiditet në fund të vitit 2007, prandaj edhe kjo është pasqyruar në deklaratë. Këto shpjegime rezultojnë të deklaruara nga subjekti edhe në aktin e titulluar “Shpjegime mbi pyetjet e ILDKPKI” me nr. {***} prot., e datës 17.11.2011, të depozituar në ILDKPKI për të pasqyruar përgjigjet e tij pas pyetjeve të bëra nga institucioni për disa pasaktësi të konstatuara në deklaramet e subjektit të rivlerësimit në ato vite.

10.19 Të njëjtat fakte deklarohen edhe nga shoqëria “{***}” ShPK në shkresën që kjo shoqëri i ka përcjellë Kolegjit, në përgjigje të kërkesës së trupit gjykues për informacion në funksion të hetimit gjyqësor të çështjes. Shoqëria “{***}” ShPK, në përgjigjen e saj konfirmon faktin e deklaruar prej subjektit se kontrata mes tyre është zgjidhur me marrëveshje mes palëve dhe se shoqëria i ka kthyer mbrapsht subjektit të gjithë shumën e paguar prej tij, duke qenë se marrëdhënia nuk ekzistonte më. Gjithashtu shoqëria “{***}” ShPK, në përgjigjen²⁷ drejtuar Kolegjit, ka evidentuar faktin se ky apartament i prenotuar nga subjekti i është shitur më pas një shtetasi tjetër, z. A. L., i cili e ka regjistruar këtë pasuri në emër të tij më datë 07.04.2010 dhe më pas me kontratën nr. {***} rep., datë 07.06.2018, ia ka shitur atë një shtetasi tjetër, z. E. F., i cili figuron të jetë pronari i ligjshëm i saj dhe poseduesi real i pasurisë.

10.20 Në analizë të këtyre të dhënave, Kolegji krijon bindjen se mosdeklarimi i marrjes mbrapsht të shumës prej 17.000 eurosh, është i lidhur me faktin se në fund të vitit të deklaramit, gjendja *cash* e subjektit nuk kishte pësuar ndryshime për shkak të zgjidhjes së kontratës së porosisë dhe me mënyrën se si ai ka interpretuar rubrikën e ndryshimeve të pasurisë së paluajtshme e të luajtshme në deklaratën e vitit 2007, në raport me parashikimet e nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, duke konsideruar se lidhja dhe zgjidhja e kontratës së porosisë nuk rezulton të jetë shoqëruar me ndonjë penalitet që do sillte si pasojë ndonjë kufizim në shumën e paguar nga subjekti si çmim i objektit. Gjithashtu, fakti që pasuria është tjetërsuar në favor të personave të tjerë, që edhe e posedojnë atë me tagra të plota pronësie, nuk krijon mundësinë e pasjes së ndonjë dyshimi se zgjidhja ka qenë

²⁷ Me shkresën e regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 21.07.2021.

fiktive. Duke analizuar në mënyrë të arsyeshme deklaratimet e subjektit në vite, por edhe gjatë procesit të rivlerësimit, si edhe ato të dhëna nga shoqëria kontraktuese, bëhet i besueshëm shpjegimi i subjektit se zgjidhja e kontratës ka ndodhur dhe se palët janë kthyer në gjendjen e mëparshme.

10.21 Ky fakt, përveçse si një deduksion i një analize logjike dhe ligjore të rrethanave të përmendura më lart, rezulton i pasqyruar edhe në shpjegimet që subjekti ka dhënë në përgjigje të pyetjeve të pasqyruara në procesverbalin e datës 17.11.2011 dhe të shtruar nga inspektorja e lartë e ILDKPKI-së, R. R.. Kolegji vëren se ky akt është hartuar në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9049/2003, i cili parashikon se: *Kur gjatë kontrollit zbulohet se deklaratimet nuk janë të sakta ose burimet e deklaruara nuk identifikohen dhe nuk mbulojnë pasuritë e deklaruara, Inspektorati i Lartë thërret subjektin për të dhënë shpjegime të hollësishme dhe argumentet përkatëse, të cilat paraqiten kurdoherë me shkrim brenda 15 ditëve nga data e njoftimit.* Në këto kushte, ky procesverbal i hartuar mbështetur mbi një dispozitë ligjore nga organi kompetent, vlerësohet se është një dokument zyrtar në kuptim të nenit 49, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, i cili për më tepër është administruar nga Komisioni zyrtarisht prej institucionit që e ka hartuar atë në funksion të procesit të rivlerësimit. Kolegji vlerëson me rëndësi të nënvizojë faktin se përpilimi i këtij dokumenti zyrtar jo vetëm që është bërë nga organi kompetent në përputhje me procedurën dhe formën e kërkuar prej ligjit²⁸, por ai daton në një kohë të largët e pa lidhje me kontekstin e procesit të rivlerësimit e në zbatim të tagrave ligjorë të tij, duke krijuar bindjen se të dhënat e përfutuara në këtë dokument, nëpërmjet shpjegimeve të dhëna nga subjekti, kanë shëruar pasaktësitë në deklaratime të subjektit të rivlerësimit në funksion të zbatimit të ligjit nr. 9049/2003, në mënyrë autonome nga procesi i rivlerësimit. Në këtë kontekst, Kolegji çmon se vlera provuese e këtyre deklaratimeve në këtë çështje, është e rëndësishme dhe nuk mund të anashkalohet nën frymën e një shqyrtimi objektiv të çështjes. Në zbatim të parashikimit kushtetues të nenit Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, organet e rivlerësimit kanë detyrimin të shqyrtojnë deklaratat e subjektit për të shkuarën e tij dhe sigurisht të përcaktojnë vlerën e tyre provuese në raport e harmoni me të gjitha rrethanat e faktit që rezultojnë nga burime të tjera. Në këtë këndvështrim, këto shpjegime të

²⁸ Për subjektin e rivlerësimit Sokol Ngresi, ILDKPKI-ja konfirmon se ka të administruara 3 (tri) akte me anë të të cilave ai shpjegon pjesë të caktuara të deklaratimeve të tij periodike. Këto akte datojnë përkatësisht më datë **23.03.2007, me nr. {***}**, me anë të të cilit subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me DPV-2004 mbi çfarë përfaqëson shuma e kursimeve në cash 18 000 euro. Procesverballi me anë të të cilit i kërkohen shpjegime subjektit të rivlerësimit, i datës **03.11.2011**, është hartuar nga inspektorja e lartë e këtij organi, znj. R. R., dhe mban nënshkrimin në çdo faqe të subjektit të rivlerësimit (që provon dijeninë e tij), si dhe të nën/Inspektorit të Lartë. Në këtë procesverbal, subjektit i janë kërkuar shpjegime lidhur me atë çfarë ka ndodhur me kontratën e porosisë të shoqërisë “{***}” ShPK, me kthimin e shumës 17 000 euro që përfaqësonin pagesën e kështit të parë të shoqëria “{***}” ShPK, si dhe i janë kërkuar shpjegime për të saktësuar vlerën në cash që ka zotëruar deri më 31.12.2010. Lidhur me këto pyetje, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur me shkrim me shkresën e emërtuar “Shpjegime mbi pyetjet e ILDKP”, të cilat janë administruar në ILDKPKI me nr. {***}, datë **17.11.2011**, të cilat nga pikëpamja e formës mbajnë vulën hyrëse të këtij institucioni në çdo fletë. Në këto shpjegime, subjekti është shprehur se: i) për shkak të ndryshimit të kushteve të kontratës nga shoqëria “{***}” ShPK, ka zgjidhur me mirëkuptim kontratën e porosisë duke iu rikthyer në cash shuma prej 30.000 eurosh nga “{***}” ShPK; ii) për shkak të një norme të pëlqyeshme interesit të depozitave në euro, në masën 4,1%, një pjesë e shumës në cash prej 15 000 eurosh, është lënë si depozitë pranë “Credins Bank” Vlorë për një periudhë 3-mujore, nga 07.11.2007 deri më 07.02.2008. Me mbarimin e afatit të kësaj depozite, kjo shumë prej 15 000 eurosh, së bashku me interesin e përfutur është tërhequr dhe është disponuar si kursim në cash së bashku me pjesën tjetër prej 19 000 eurosh; iii) pas kësaj, gjendja në cash, në euro, që disponojo ishte 34 000 euro; iv) lidhur me gjendjen e kursimeve në cash, më 31.12.2010, subjekti ka deklaruar se dispononte 36.000 euro, pjesë e së cilës ishte edhe vlera 16.000 euro, e marrë kredi nga NBG Bank Vlorë, si dhe 1.400.000 lekë.

Në datën **22.09.2014**, ILDKPKI-ja ka thirrur dhe ka pyetur në prezencë të inspektorit të saj, subjektin e rivlerësimit duke e dokumentar këtë proces në një procesverbal të vulosur me vulën e sekretarisë së institucionit e të nënshkruar në çdo faqe nga subjekti dhe inspektori përkatës. Me anë të këtij procesverbali, subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me lëvizjet, gjendjet dhe interesat e llogarive bankare, si dhe me vlerat e shitjeve të automjeteve.

subjektit të dhëna në të kaluarën e tij e pikërisht në funksion të sqarimit të pasaktësive në plotësimin e deklaratave periodike të tij përpara institucionit të vetëm përgjegjës për deklarimin e pasurive, nuk mund të abstragohen dhe konsiderohen inekzistente, si akte që japin informacion relevant për çështjet e procesit të tij të rivlerësimit. Mbi të gjitha, krijimi i tyre i provuar jashtë kontekstit të procesit të rivlerësimit dhe në mungesë edhe teorike, jo vetëm praktike, të qëllimit të subjektit për të deformuar veprimtarinë hetimore për vlerësimin e pasurisë sipas këtij procesi, u japin këtyre deklaratimeve kredibilitetin e nevojshëm për t'u përdorur në analizën që trupa gjyqësore vlerëson të bëjë për çështjet e ngritura në ankim prej Komisionerit Publik.

10.22 Kolegji kreu analizën financiare në funksion të verifikimit të pretendimit tjetër të Komisionerit Publik që lidhej me pamundësinë e subjektit për të krijuar me burime të ligjshme shumë prej 17.000 eurosh në vitin 2007, në momentin e përdorimit të saj si burim për pagimin e këstit të parë të apartamentit të prenotuar te shoqëria “{***}” ShPK. Ndonëse në thelb të këtij pretendimi të Komisionerit Publik qëndronte fakti se subjekti nuk i kishte këto mundësi për shkak se ai ishte në pamundësi të krijonte shumë prej 18.000 eurosh në vitin 2004, pretendim për të cilin Kolegji ndan qëndrim të ndryshëm si më sipër arsyetuar, u analizuan mundësitë financiare të subjektit edhe mbështetur në shpjegimin e tij se kjo shumë e krijuar si gjendje *cash* në vitin 2004, nuk ishte 18.000 euro, por vetëm ½ e saj, pra 9000 euro. Siç është arsyetuar edhe në paragrafët më sipër, në analizën financiare të kryer, Kolegji përdori këtë shumë si vlerën e pasurisë likuiditet që subjekti zotëronte në vitin 2004, mbështetur pikërisht në deklaratimet e subjektit dhe, mbi këtë vlerë, analizoi shtesat dhe pakësimet e pasurisë likuiditet në gjendje *cash*, krahas shpenzimeve të tjera të kryera prej subjektit të rivlerësimit deri në datën e pagesës së shumës prej 17.000 eurosh shoqërisë “{***}” ShPK. Në këtë analizë, shihet e nevojshme të evidentohet fakti se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në dokumentin “Shpjegime mbi pyetjet e ILDKP” të vitit 2011, në të cilin ai shpjegon se *nga pasuria e grumbulluar në vite nga puna e tij dhe e bashkëshortes, kishte gjendje cash rreth 18.000 euro në vitin 2007*, i referohet gjendjes *cash* të krijuar nga *cash*-i i vitit 2004, së bashku me shtesat e kursimeve në *cash* për vitet 2005 e 2006, pavarësisht faktit se kjo shumë përkon me shumë prej 18.000 eurosh të deklaruar në DPV-2004. Nëse do të konsiderohej se gjendja në *cash* e subjektit në vitin 2004 ishte 18.000 euro, ai do të kishte mundësi të krijonte një vlerë pasurie më të madhe në vitin 2007, referuar edhe shtesave të deklaruara në vitet më pas.

10.23 Në analizën e kryer në Kolegj për vitin 2005²⁹, si gjendje e *cash*-it të akumuluar, është konsideruar vlera prej 900.000 lekësh, e ndryshme nga shuma prej 450.000 lekësh që Komisioni ka përfshirë në analizën e tij. Në referencë të evidentimit të gjendjes së *cash*-it që subjekti kishte në dispozicion në përfundim të vitit 2005, Kolegji llogariti edhe gjendjen totale të kursimeve në *cash* në fund të këtij viti, e cila përbëhej nga 9.000 euro si pjesë takuese e kursimeve të deklaruara në DPV-2004 (½ e 18.000 eurove), plus 900.000 lekë në *cash* të krijuara përgjatë vitit 2005. Bazuar

²⁹ *Analiza e kryer në Kolegj për vitin 2005, ndryshon me analizën e Komisionit së pari në gjendjen totale të cash-it të konsideruar në fund të vitit, e cila sipas Kolegjit rezulton në masën 900.000 lekë dhe sipas Komisionit, në masën 450.000 lekë. Ky ndryshim vjen për shkak se subjekti i rivlerësimit, përveç deklaratimeve në rubrikën e ndryshimit të pasurisë, në seksionin e të dhënave konfidenciale të DPV-2005, ka deklaruar mbylljen e depozitës së kursimeve me afat 3-mujor dhe disponimin e shumës 450.000 lekë si gjendje në cash, shumë e cila nuk është përfshirë në analizën ekonomike të Komisionit. Përveç deklaratimit të rubrika e të dhënave konfidenciale të mbylljes së llogarisë së kursimeve dhe kalimin e vlerës së saj prej 450.000 lekësh si gjendje cash, në të njëjtin DPV subjekti ka deklaruar gjithashtu se ka shtuar kursimin në cash me 450.000 lekë. Nisur nga ky deklarim i subjektit në DPV-2005, si likuiditete në cash të disponuara prej subjektit, Kolegji ka përfshirë në analizën e vitit 2005 shumë prej 900.000 lekësh. Ndryshimi i dytë i analizës financiare konsiston në mospërfshirjen e llogarisë bankare në emër të personit të lidhur në ABI Bank (NBG)²⁹, në shumë 100 euro, me vlerë ekuivalente me 12.674 lekë, si dhe me një pasaktësi në lidhje me gjendjen e llogarisë së personit të lidhur pranë Procredit Bank më datë 31.12.2004, e cila konsiston në shumë 5.454 lekë dhe jo 3.261 lekë, e konsideruar në analizën ekonomike të Komisionit.*

në analizën financiare të Kolegjit, gjendja në fund të vitit 2005 rezulton me diferencë pozitive prej 632.856 lekësh.

10.24 Lidhur me blerjen e automjetit Mercedes Benz, Kolegji, pasi vlerësoi situatën faktike dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me fondet e përdorura për blerjen e tij, çmoi se blerja e tij është bërë me fondet e vitit 2005 dhe, në këto kushte, analiza e kryer në Kolegj për vitin 2006³⁰, rezultoi me situatë financiare pozitive.

10.25 Sipas analizës financiare të kryer në Kolegj mbi të dhënat e mësipërme, rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi të justifikonte me burime të ligjshme shumë prej 17.000 eurosh në gjendjen *cash*, të përdorura prej tij si burim për pagimin e kështit të parë për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK. Për sa më sipër, Kolegji arriti në konkluzionin se subjekti kishte kursime të krijuara me burime të ligjshme në shumë prej 17.000 euro në vitin 2007, të përdorura prej tij për pagimin e kështit të parë për prenotimin e apartamentit të shoqëria “{***}” ShPK dhe këtë shumë në gjendje *cash* e kishte sërish në zotërim të tij në fund të vitit 2007, si pasojë e zgjidhjes së kontratës me shoqërinë dhe kthimin mbrapsht jo vetëm të shumës prej 16.000 eurosh, të financuara me kredinë në bankën NBG, por edhe të shumës prej 17.000 eurosh, të financuar prej kursimeve të tij në vite. Mosdeklarimi i kësaj rrethane në deklaratën e vitit 2007, mbetet një pasaktësi në deklaratën periodike, për më tepër e saktësuar e plotësuar me shpjegimet e dhëna nën këtë kuadër sipas legjislacionit të kohës me anë të akteve/procesverbaleve të kontrollit pranë organit kompetent ILDKPKI, shpjegime të cilat shërojnë këtë defekt në raport me provueshmërinë e faktit, ndërsa mbetet e njëjtë logjika se subjekti nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për këtë pasaktësi në deklaratimet periodike, për sa kohë që justifikohet bindshëm mundësia që ai të krijonte këtë pasuri me burime të ligjshme. Në këtë logjikë, pavarësisht se Komisioni nuk ka adresuar ndonjë çështje të dedikuar kësaj situatë, qëndrimi që ai ka mbajtur duke konsideruar këtë shumë në analizën financiare të kryer për vlerësimin e mundësisë së pagimit të kështit prej 20.000 eurosh për apartamentin e blerë në lagjen “{***}” në vitin 2012, si një burim i ligjshëm i subjektit, gjendet i drejtë.

10.26 *Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se subjekti ka kryer mosdeklarim në DVP-2009 (në momentin e rikthimit në detyrë dhe rikthim si subjekt deklarimi) të posedimit të kursimeve në cash apo destinacionin e shumës së tërhequr me burim kredinë pranë NBG Bank, Kolegji analizon sa vijon.*

10.27 Për këtë çështje, në vendimin objekt shqyrtimi konstatohet se nuk ka qëndrime specifike lidhur me pasqyrimin e këtyre kursimeve në DVP-2009, por, në raport me analizën tërësore të mundësisë së krijimit të tyre, në vendim është konkluduar se: *Sa i përket mundësisë së krijimit të gjendjes cash ndër vite, për periudhën 2004 – 2012, deri në momentin që subjekti ka paguar shumë prej 50.000 eurosh shoqërisë së ndërtimit, referuar tabelës së analizës financiare përmbledhëse [...], duket se subjekti ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme për ta krijuar atë dhe për ta përdorur si burim.*

³⁰ Blerjen e autoveturës tip “Mercedes Benz”, të blerë me kontratën e datës 30.01.2006, Kolegji e ngarkoi në analizën financiare të vitit 2005. Rezultati pozitiv i vitit 2005 prej 632.856 lekësh, edhe pas konsiderimit të shpenzimit prej 500.000 lekësh për blerjen e autoveturës, rezulton përsëri në vlera pozitive prej 132.856 lekësh. Për vitin 2006, Kolegji konstaton se ndryshimi i dy analizave qëndron në gjendjen e llogarive bankare në fund të vitit. Në analizën e Komisionit nuk është përfshirë depozita e çelur në fund të vitit 2006 (28.12.2006), në shumë prej 150.000 lekë, në emër të personit të lidhur pranë ABI Bank (NBG) (shifër e pretenduar dhe nga ana e Komisionerit si e papërfshirë në analizën e Komisionit), si dhe shuma prej 66.014 lekësh, e cila përfaqëson gjendje likuiditeti në dy llogari pranë Fibank. Analiza financiare e vitit 2006 për Kolegjin rezultoi në vlera pozitive prej 298.699 lekësh, pasi shpenzimi për blerjen e autoveturës iu ngarkua analizës financiare të vitit 2005.

10.28 Në funksion të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi të Komisionerit Publik, Kolegji konstaton me rëndësi të veçantë analizën dhe interpretimin e deklaramëve të subjektit të rivlerësimit në vitin 2010, moment kur ai deklaroi rishitas me kthimin e tij në detyrë. Siç ka rezultuar nga aktet e administruara, subjekti i rivlerësimit është shkarkuar nga detyra e gjyqtarit me vendimin nr. {***}, datë 20.02.2008, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ai është rikthyer në detyrë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në zbatim të vendimit nr. {***}, datë 23.06.2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që e kishte gjetur shkarkimin e tij të padrejtë. Rezulton se subjekti nuk ka plotësuar formularin e deklarimit para fillimit të detyrës brenda afatit 30-ditor, në tetor të vitit 2009, sipas përcaktimit të nenit 5/1 të ligjit nr. 9049/2003. Subjekti, siç është evidentuar edhe më sipër, nuk ka plotësuar as formularin e deklarimit pas largimit nga funksioni, në kohën kur e ka lënë detyrën në formatin e tij të miratuar sipas nenit 7, pika 1 e ligjit nr. 9049/2003, por ai ka plotësuar në mars të vitit 2008, formatin e deklarimit periodik vjetor që i përkiste vitit 2007, duke përfshirë në të edhe të ardhurat e realizuara deri në ditën e qenies në detyrë, shkurt të vitit 2008, pra të ardhurat e realizuara përtej afatit të deklarimit vjetor.

10.29 Të njëjtin format deklarimi, subjekti e ka ndjekur edhe pas rikthimit në detyrë, duke plotësuar në mars të vitit 2010, gati pesë muaj pas kthimit në detyrë, formularin e miratuar për plotësimin e deklaramëve periodike, të emërtuar me shkrim dore në pjesën hyrëse të tij, si “para fillimit të detyrës”. Në këtë deklaratë që vetë subjekti i rivlerësimit e ka cilësuar si modeli “para fillimit të detyrës”, e cila mban datën 19.03.2010, ai ka deklaruar të ardhurat nga avokatia në shumën 3.200.000 lekë, për të cilat rezultojnë të paguara detyrimet tatimore e që janë realizuar përgjatë periudhës qershor 2008 deri në tetor 2009, kohë kur ai ushtronte këtë profesion për shkak të shkarkimit nga detyra e gjyqtarit. Në të njëjtën deklaratë rezulton se subjekti ka deklaruar të gjitha lëvizjet me pasuritë, të cilat konsistojnë në shitje e blerje automjetesh, të ndodhura përgjatë këtij harku kohor. Nuk gjenden në këtë deklaram të dhëna në lidhje me pasuritë e tij likuiditet dhe as rezultojnë të dhëna që tregojnë se subjekti ka pësuar ndryshime në drejtim të pasurive të paluajtshme. Praktikisht, subjekti rezulton të ketë plotësuar dhe mbushur me të dhëna këtë format deklarimi, sipas rubrikave që ai propozonte, të cilat duke qenë se ishin sipas formatit të deklarimit periodik, përmbanin rubrika që orientonin deklaramet vetëm mbi ndryshimet e pasurisë dhe jo gjendjen e përgjithshme të saj në ditën e plotësimit të deklaratës. Nga analiza që i bëhet mënyrës se si ka deklaruar subjekti, konstatohet se ai nuk ka plotësuar saktë, në formatin e duhur e mënyrën e duhur, deklaramet e pasurisë pas largimit nga funksioni dhe para fillimit të detyrës, siç përcaktonte ligji nr. 9049/2003.

10.30 Në vijim të këtij konstatimi dhe referuar pretendimit të subjektit se nuk ishte përgjegjësia e tij plotësimi i deklaratës së gabuar, por i institucioneve që i kishin vënë atij në dispozicion deklaratën në formatin e gabuar, meqenëse në kohën e përpilimit të tyre, nuk ishte i mundur aksesi *online* i deklaramëve, por vetëm plotësimi i tyre në formatin *hard copy*, Kolegji kërkoi informacion prej ILDKPKI-së lidhur me këtë moment³¹. Në përgjigjen e sjellë prej ILDKPKI-së³², pasqyrohej shpjegimi se në periudhën 2007-2010, kanë qenë të miratuara modelet e deklarimit, para fillimit të detyrës, pas largimit nga funksioni dhe periodik, sipas urdhrave të Inspektorit të Përgjithshëm nr. {***}, datë 10.10.2006 dhe nr. {***}, datë 26.12.2008, të botuara edhe në fletoret zyrtare, respektivisht me nr. 109/2006 dhe nr. 188/2008. Sipas kësaj përgjigjeje, këto modele kanë qenë të publikuara dhe të aksesueshme edhe *on-line*, në faqen zyrtare të institucionit, por njëkohësisht

³¹ Marrjen prej ILDKPKI-së informacion mbi mënyrën dhe praktikën e ndjekur nga ky institucion për vënien në dispozicion të subjekteve deklaramëve të modeleve të deklaramëve periodike, të deklaramëve fillestare dhe asaj pas largimit nga detyra për periudhën 2007-2010. Të kërkohet informacion nga ky institucion nëse këto modele ishin të aksesueshme *on-line* nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të institucionit për periudhën e cituar më lart.

³² Me shkresën e ILDKPKI-së nr. {***}, datë 16.07.2021.

ILDKPKI-ja është kujdesur t'ua përcjellë ato institucioneve përkatëse që kishin subjekte deklaruese, edhe në kopjen fizike të tyre.

10.31 Subjekti i rivlerësimit debatoi gjyqësisht mbi këtë informacion të përcjellë prej ILDKPKI-së, duke analizuar se edhe sipas përmbajtjes së urdhrin nr. 188/2008 të botuar në fletoren zyrtare nr. 77/2008, në formularin “Deklaratë e interesave privatë para fillimit të detyrës”, në faqen e dytë theksohet qartë: *Dokumenti “Deklaratë e interesave private” i ofrohet zyrtarit nga Autoriteti Përgjegjës (Drejtorja e Burimeve Njerëzore) i institucionit ku kryen funksionin publik, sipas rastit, aty mund të kërkon konsultë ligjore.* Sipas subjektit, në zbatim të këtij parashikimi, në vitin 2010, kohë kur ai ka plotësuar deklaratën para fillimit të detyrës, ka dalë shkresa nr. {***} prot., datë 18.1.2010, e KLD-së, me përmbajtje si vijon: *Për të përmbushur këtë detyrim ligjor, kërkohet bashkëpunimi juaj me kancelarin e gjykatës për organizimin e punës, lidhur me shpërndarjen, grumbullimin dhe dërgimin e deklaratave të interesave privatë, brenda afatit të sipërcituar, për të gjithë gjyqtarët. Bashkëlidhur shkresës, do të gjeni formularët “Deklaratë e interesave privatë periodik/vjetor”.* Po në këtë shkresë, citohet detyrimi: *duke pasqyruar në të vetëm ndryshimet e ndodhura në interesat privatë të deklaruar më parë, interesat e lindur gjatë vitit që deklarohet dhe çdo e ardhur e fituar gjatë gjithë vitit për të cilin bëhet deklarimi, dhe procedura ka vijuar me dorëzimin për plotësim të subjekti i deklaratës para fillimit të detyrës në formatin e deklaratës periodike, të vënë në dispozicion prej kancelares së gjykatës. Në këtë mënyrë, subjekti pretendon se ai nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për plotësimin e formularit të gabuar, duke qenë se strukturat përgjegjëse i kanë vënë atij në dispozicion pikërisht atë model. Sipas subjektit, kopjet elektronike të formularëve janë bërë të aksesueshme *on-line* vetëm pas miratimit të urdhrin të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së me nr. {***}, datë 22.11.2012, i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 154, datë 3.12.2012.*

10.32 Kolegji vlerësoi së pari këtë çështje duke analizuar rrethanat e prezantuara më lart rreth modaliteteve të plotësimit të deklaratës në vitin 2010, në funksion të përcaktimit të ndonjë përgjegjësie të mundshme të subjektit lidhur më këtë anomali në procesin e deklarimit të tij sipas ligjit nr. 9049/2003. Së pari, Kolegji konstatoi se vetë institucionet e përfshira në këtë proces, ILDKPKI-ja dhe KLD-ja apo njësitë e autorizuar nga ligji në gjykata, kanë prodhuar orientime të ndryshme në drejtim të mënyrës se si duheshin plotësuar formularët në vitin 2010, në formë të shkruar apo elektronike. Në këtë drejtim, duket se ka dominuar dhe është preferuar në atë kohë forma shkresore, e cila është përdorur më tepër prej subjekteve të rivlerësimit. Pavarësisht se bëhet e pamundur të përcaktohet pa ekuivok nëse ka ekzistuar ose jo mundësia e aksesimit *on line* të formularëve, për shkak të përmbajtjes disi të ndryshme të shkresave të administruara në gjykim në lidhje me këtë çështje, Kolegji konstaton se urdhri i Inspektorit të Përgjithshëm që miratonte formularë të dedikuar për secilën nga rrethanat që impononin deklarim para ILDKPKI-së, kishte dalë dhe ishte botuar në Fletoren Zyrtare, në vitin 2007 e 2008, duke fituar në këtë mënyrë statusin e një akti normativ e të detyrueshëm për zbatim.

10.33 Në këtë kontekst, Kolegji çmon se pavarësisht nga formati që strukturat përgjegjëse i kanë vënë në dispozicion subjektit për t'u plotësuar e mungesës së pretenduar të aksesit *on line* mbi këto formate, subjekti nuk mund të shkarkohet nga përgjegjësia për mosnjohjen e tyre në zbatim të prezumimit ligjor të njohjes së ligjit, aq më shumë prej një funksionari të sistemit të drejtësisë. Në vijim, Kolegji vlerëson se përgjegjësia e subjektit për plotësimin e formularit të gabuar, do të transpozohet në procesin e rivlerësimit në pamundësinë e tij për të provuar faktet të cilat duheshin deklaruar në deklaratat përkatëse, si të vetmet dokumente që mund të provonin rrethana të caktuara në interes të procesit të rivlerësimit, tipikisht gjendjet e pasurisë likuiditet në *cash*, të cilat rezultojnë të pamundura për t'u provuar me mënyra të tjera. Në këto kushte, subjekti do të ishte në pamundësi të provonte ato që ai pretendon në lidhje me gjendjet *cash* para fillimit të detyrës për

shkak të këtij gabimi në deklarime, e kjo do të konsiderohej përgjegjësia e tij në raport me procesin e rivlerësimit.

10.34 Në kontekstin e situatës konkrete, Kolegji vëren se këto pasaktësi në deklarime janë konstatuar në kohë edhe nga vetë organi kompetent i kontrollit, ILDKPKI, i cili në zbatim të parashikimeve ligjore, nenit 27 të ligjit nr. 9049/2003, ka proceduar me pyetjen e subjektit deklarues për të sqaruar çështje që duhet të kishin gjetur përgjigje në deklarime, por edhe të tjera të lindura nga kontrolli i deklaratës. Subjekti u është përgjigjur pyetjeve të inspektorëve të datës 3 nëntor 2011 e datës 22 shtator 2014, duke dhënë informacion në këto përgjigje edhe për mungesat apo pasaktësitë në deklaratimet e viteve 2007 dhe 2010. Siç është arsyetuar edhe më lart, këto akte u konsideruan nga Kolegji si dokumente ligjore dhe me vlerë provuese për sa deklarohet në to, për pasojë deklaratimet e subjektit në këto dokumente janë analizuar në tërësi me të gjitha të dhënat që rezultojnë nga të gjitha aktet e tjera të administruara në proces, e kanë sjellë informacion të vlefshëm me vlerë provuese për disa nga rrethanat e padeklaruara në deklaratën para fillimit të detyrës, ashtu si edhe për deklaratën e vitit 2007 pas largimit nga funksioni.

10.35 Kolegji vlerëson se fakti që këto deklarime janë bërë nga subjekti për të shëruar pasaktësitë në deklarime të konstatuara dhe vlerësuara prej institucionit përgjegjës të kohës, duhet të konsiderohen në vlerësimin e deklarimeve të tij për çështjet që ngrihen në ankimin e Komisionerit Publik e që lidhen me deklaratimet gjendjes *cash* në momentin e deklaratimit të parë pas marrjes së detyrës.

10.36 Sipas analizës harmonike të deklarimeve në deklaratën e para fillimit të detyrës, shpjegimeve të dhëna gjatë procesit të rivlerësimit në Komision e në Kolegji, si edhe deklarimeve të bëra para ILDKPKI-së, arrihet në disa konkluzione si më poshtë.

- Subjekti ka poseduar në momentin e rifillimit të detyrës, shumat në *cash* për të cilat ai kishte bërë deklaratimet e fundit në deklaratën e vitit 2007 e të cilat nuk rezultojnë se janë përdorur deri në momentin e përpilimit të deklaratës në mars të vitit 2010 për investime apo financime të tjera.
- Në këtë logjikë, Kolegji e konsideron bindës pretendimin e subjektit se ai ka poseduar të paktën shumën prej 17.000 eurosh, të paguar si këst i parë dhe kthyer mbrapsht prej shoqërisë “{***}” ShPK në vitin 2007, si edhe shumën prej 15.655 eurosh, të përfituar prej kredisë bankare nga banka NBG e të kthyer nga shoqëria “{***}” ShPK [me transfertë bankare me përshkrimin “kalim fondi” më datë 05.11.2007, në llogarinë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit pranë Raiffeisen Bank, nga e cila është tërhequr në *cash* më datë 07.11.2007.]
- Përveç sa më sipër, në mbështetje të këtij argumenti, është edhe fakti që subjekti ka deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës pasuritë e luajtshme të fituara dhe të tjetërsuara deri në këtë moment si të financuara me të ardhurat e krijuara nga puna si avokat dhe të ardhurat nga puna si gjyqtar pas rifillimit të detyrës, pa u shprehur në asnjë moment se ai ka prekur apo përdorur kursimet e tij për financimin e këtyre pasurive. Ndërsa në përgjigjet që subjekti ka dhënë në ILDKPKI, ka potencuar faktin se ai ka poseduar shumën prej 34.000 eurosh në kohën e lënies së detyrës, të përbërë prej kursimeve dhe pjesës së kredisë bankare.

10.37 Në përfundim të kësaj analize ligjore, Kolegji verifikoi mundësitë e subjektit në terma financiarë për të justifikuar me burime të ligjshme shumën prej 20.000 eurosh, të paguar prej tij si këst i parë te shoqëria “{***}” ShPK, për blerjen e apartamentit të ndodhur në lagjen “{***}” Vlorë, me mandatar-këtimin nr. {***}, datë 14.11.2012, me përshkrimin: *arkëtuar nga Sokol dhe L. Ngresi shuma prej 20.000 eurosh, për prenotim apartamenti me sip. 144 m², duke qenë se pretendimet e Komisionerit Publik të trajtuara më lart afektonin në finale mundësinë financiare të subjektit për të justifikuar me burime të ligjshme pikërisht pagimin e kësaj shume. Nga analiza*

financiare e kryer në Kolegj, rezultoi se subjekti kishte likuiditet në gjendje *cash*, të krijuar me burime të ligjshme për të justifikuar pagimin e këstit prej 20.000 eurosh në datën 14.11.2012 .

10.38 Në përfundim, lidhur me shkakun e parë të ankimit të Komisionerit Publik i cili ka të bëjë me verifikimin e burimeve të ligjshme që pas disa transaksionesh dhe veprimesh juridike kanë shërbyer në finale si burim financimi për blerjen e apartamentit prej 148,8 m² në {***}, Vlorë, Kolegji vlerëson se:

Pavarësisht deklarimeve të paplota të subjektit të rivlerësimit në vitet e pretenduara prej Komisionerit Publik, veçanërisht në deklaratën para fillimit të detyrës të datës 19 mars 2010, të plotësuar sipas orientimit të formatit të gabuar të deklaratës, nga analiza e të gjitha të dhënave që rezultojnë prej tyre, krahas të dhënave që rezultojnë prej deklarimeve të subjektit, në përgjigje të pyetjeve të dedikuara specifikisht për sqarimin e kësaj çështjeje prej ILDKPKI-së në vitet 2011 e 2014, si edhe nga ato që përftohen nga shpjegimet e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, të cilat konstatohet se qëndrojnë në harmoni me njëra-tjetrën, krijon bindjen se ato janë të besueshme e të mjaftueshme për të kapërcyer testin e besueshmërisë së deklarimeve dhe justifikimit me burime të ligjshme të pasurisë sipas parashikimeve të pikave 1 e 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës e nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

10.39 *Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e mosdeklarimit të pagesës së këstit prej 7.160 eurosh në DPV-2014 (të cilën e ka deklaruar në DPV-2016) duke u konsideruar në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për pagimin e tij, si dhe në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për pagesën e këstit prej 8.000 eurosh në vitin 2015, Kolegji mori në shqyrtim rrethanat e mëposhtme.*

10.40 *Në vendimin e Komisionit lidhur me pagimin e këstit të vitit 2014, arsyetohet se Komisioni gjithashtu kreu analizën financiare për mundësinë e blerjes së pasurisë me burime të ligjshme për vitet 2012, 2014 dhe 2015 sipas mandatpagesave bërë shoqërisë së ndërtimit, referuar së cilës rezultoi se subjekti nuk justifikon me burime të ligjshme pagesën e bërë në dhjetor të vitit 2014 dhe atë të kryer në shkurt të vitit 2015. Balanca totale negative për këto dy pagesa është në shumën (-) 542.856 lekë. [...] Por tashmë Komisioni ka një standard të vendosur, i unifikuar për të gjitha subjektet, në të gjithë territorin e vendit, pavarësisht vendbanimit të tyre. Në vijim të këtij argumenti, Komisioni argumenton se balanca negative e rezultuar nga analiza financiare për subjektin, nuk është në atë masë sa subjekti të konsiderohet fajtor dhe, për pasojë, të passjellë aplikimin e një mase disiplinore.*

10.41 Nga aktet e administruara në hetimin administrativ lidhur me këtë çështje, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka shlyer çmimin e plotë të apartamentit të blerë prej tij prej shoqërisë “{***}” ShPK, përveçse me pagimin e këstit prej 20.000 eurosh të analizuar më sipër, këstin prej 30.000 eurosh nëpërmjet financimit me kredinë bankare të marrë në Raiffesisen Bank, si edhe dy kësteve: prej 7.156 eurosh, të shlyera me mandatar-këtimin nr. {***}, datë 18.12.2014 dhe prej 8.000 eurosh, të shlyera me mandatar-këtimin nr. {***}, datë 22.02.2015. Nga analiza e deklaratës periodike të vitit 2014, vit në të cilin është kryer pagesa e këstit prej 7.156 eurosh, rezulton se subjekti nuk ka bërë asnjë deklaram për pagimin e kësaj shume si pjesë e çmimit të blerjes së apartamentit të ndodhur në lagjen “{***}” në Vlorë. Subjekti rezulton ta ketë deklaruar pagimin e këtij kësti në deklaratën periodike të vitit 2016, duke e konsideruar si këstin e fundit të paguar për çmimin e apartamentit me burimet nga kursimet e këtij viti dhe nga kursimet e mëparshme. Subjekti ka shpjeguar se mosdeklarimi i pagimit të këtij kësti në vitin 2014, është një pasaktësi të cilën ai e ka ndrequr duke e deklaruar pagesën e tij në vitin 2016, sapo e ka konstatuar këtë anomali.

10.42 Kolegji konstaton se është evident fakti se subjekti nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2014 shlyerjen e kësaj pagese si një prej detyrimeve të ligjit nr. 9049/2003 dhe kjo do të përbënte një

mangësi në deklaratimet periodike të tij. Fakti që subjekti e ka deklaruar pagesën e këstit në vitin 2016, duke tentuar të riparojë defektin e deklaratës së vitit 2014, përbën një element që përjashton mundësinë e pasjes nga subjekti të ndonjë qëllimi për të manipuluar organet e kontrollit të pasurisë së tij, qoftë ato të kontrollit periodik apo ato të kontrollit për efekt të procesit të rivlerësimit. Kolegji çmon se ky element, i lidhur edhe me qëndrimet e mbajtura tashmë nga jurisprudenca e Kolegjit, pavarësisht pasaktësisë në deklaratimin periodik të vitit 2014, nuk mund të jetë një rrethanë që e bën përgjegjës subjektin sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke qenë se përgjegjësia e subjektit për deklarime të pasakta të cilat mund të ngrihen në nivelin e një shkakut shkarkimi, të cilat duhet të jenë të lidhura me deklaratimet në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe njëkohësisht, sjella e subjektit e korrigjohet po prej tij brenda procesit të deklarimit periodik, e përjashton atë edhe nga ndonjë përgjegjësi që mund të lidhet me cenimin e besimit të publikut, për shkak të një sjelljeje jo të pranueshme të tij.

10.43 Pavarësisht këtij arsyetimi, në përgjigje të shkaqeve të ankimit të ngritura prej Komisionerit, Publik, Kolegji analizoi mundësitë e subjektit të rivlerësimit për të justifikuar me burime të ligjshme pagimin e këtij kësti prej 7.156 eurosh pikërisht në vitin 2014, në të cilin rezultoi se është bërë realisht pagimi i tij. Nga analiza financiare e kryer në Kolegji, rezultoi se subjekti gjendej në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar në këtë vit pagimin e këstit të mësipërm, si edhe për të përballuar të gjitha shpenzimet e tjera të cilat iu ngarkuan subjektit sipas të dhënave që kanë rezultuar nga hetimi administrativ për to, në masën prej (-) 116.372 lekë³³.

10.44 *Lidhur me pretendimin e Komisionerit se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për pagesën e këstit prej 8.000 eurosh më datë 22.02.2015 sepse ai nuk posedonte mjaftueshëm kursime në deri në shkurt të vitit 2015 për të justifikuar pjesën prej 4000 eurosh të pagesës, Kolegji mori në shqyrtim rrethanat e mëposhtme.*

10.45 Në vendimin e Komisionit nuk ka një analizë specifike dedikuar këtij fakti, por rezultoi se pasi ka kryer analizën financiare deri në momentin e pagimit të këstit të fundit prej 8000 eurosh, ka konstatuar se subjekti nuk justifikon me burime të ligjshme pagesën në shkurt të vitit 2015 me një balancë negative në shumën (-) 423.638 lekë³⁴.

10.46 Nga aktet e administruara përgjatë hetimit administrativ, rezultoi se në DPV-2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për financimin e kësaj pagese, 4000 euro nga kursimet e këtij viti dhe 4.000 euro nga kursimet e mëparshme.

10.47 Subjekti ka parashtruar se në momentin e plotësimit të deklaratës DPV-2015, dorëzuar më 30.03.2016, ka perceptuar kursimet familjare tërësore të vitit 2015, ndërkohë për kryerjen e pagesës janë përdorur kursimet e krijuara në mënyrë të pandërprerë ndër vite prej tij. Subjekti vijon shpjegimin duke u shprehur se në DVP-2015, nuk ka deklarim për shtim kursimesh pasi kjo ka qenë logjika e deklarimit që, ndërsa janë prekur kursimet e grumbulluara ndër vite, një pjesë prej 4.000 eurosh janë riakumuluar me të ardhurat e kursyera nga ky vit, duke e bërë që shuma e kursyer ndër vite në fund të vitit 2015, të pakësohet jo me 8.000 euro, por me 4.000 euro.

10.48 Kolegji vlerëson se shpjegimi i subjektit si më sipër, nuk është në koherencë me vetë deklaratimin e tij në DPV-2015, por është një shpjegim i sforcuar nga detyrimi për të justifikuar

³³ Për vitin 2014, nga analiza financiare rezultoi se analiza e Komisionit dhe ajo e Kolegjit rezultojnë me gjendje negative përkatësisht në (-)119.218 lekë dhe (-)116.372 leke dhe ndryshojnë me njëra-tjetra me vlerën 2.846 leke për shkak të mos konsiderimit në analizën e Komisionit të vlerës së llogarisë bankare të personit të lidhur në "Raiffeisen bank".

³⁴ Referuar tabelës së analizës financiare të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimit (faqe 9) rezultoi se deri më 22.02.2015 subjekti i rivlerësimit rezultoi me diferencë negative në vlerën (-) 423.638 lekë.

pamundësinë e pasjes së një sasive likuiditeti në masën prej 4.000 eurosh në momentin e pagesës së këstit në shkurt të vitit 2015. Ky shpjegim u vlerësua si jobindës dhe analiza financiare e kryer në Kolegj ndoqi logjikën e paraqitur në ankim prej Komisionerit Publik, duke analizuar mundësinë e subjektit që krahas shpenzimeve të tjera të kryera deri në datën 22.02.2015, të përballonte edhe pagesën e këstit prej 8.000 eurosh, nga të cilat 4.000 euro me të ardhurat e këtij viti dhe 4.000 euro nga kursimet viteve të mëparshme, në referim të deklarimeve të tij në DPV-2015. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezultoi se subjekti gjendej në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme në datën 22.02.2015 për të përballuar pagimin e këstit prej 8.000 eurosh, në masën (-) 362.888 lekë³⁵.

10.49 Në përfundim të analizës së këtij shkakut ankimi, lidhur me pagesat e kësteve prej 7.160 eurosh dhe 8.000 eurosh, për shlyerjen e plotë të çmimit të blerjes së kësaj pasurie, të kryera në vitet 2014 e 2015, Kolegji, pasi kreu analizën financiare për të verifikuar mundësitë e subjektit të rivlerësimit për përballimin e pagimit të tyre me burime të ligjshme, arriti në përfundimin se subjekti gjendet në mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagimin e tyre në vitet respektive, në vlerat (-)116.372 lekë dhe (-)362.888 lekë. Deklarimi prej subjektit për pagesën e këstit prej 7.160 eurosh, në deklaratën periodike të vitit 2016, ndërkohë që ishte kryer në vitin 2014, nuk u konsiderua prej Kolegjit si relevant në drejtim të kontrollit të vërtetësisë së deklarimeve të subjektit në këndvështrim të dispozitave të ligjit nr. 84/2016, për sa kohë që përcaktimet e tyre referojnë te kontrolli i deklarimeve të subjekteve në deklaratën e pasurisë *vetting*. Për sa më lart, konstatohet vetëm mungesa e burimeve të ligjshme në vlerat e sipërcituara, në kuptim të nenit 33 pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 11** *Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik për pasurinë automjet tip “Skoda Yeti”, me targa {***}, në vlerën prej 14.500 eurosh, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare për blerjen e tij me pagesat e kryera në vitet 2009 e 2010 pasi: (i) burimi i financimit të blerjes së këtij automjeti me kursimet në cash, sikur ka vepruar Komisioni, nuk mund të konsiderohet i tillë, pasi subjekti nuk ka deklaruar pakësim të cash-it të viteve të mëparshme; (ii) të ardhurat e siguruara prej shitjes së automjetit tip “Mercedes-Benz” në shumën 7.000 euro, nuk mund të konsiderohen si burim i ligjshëm pasi subjekti për këto të ardhura duhet të kishte paguar tatimin në burim për diferencën e vlerës së shitjes me vlerën e zhdoganimit të tij, meqë mjeti ishte dhuratë prej kushërinjve të tij.*

11.1 Për këtë pasuri, automjeti tip “Skoda Yeti”, me targa {***}, referuar vendimit dhe analizës financiare të kryer në Komision, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme për kryerjen e dy pagesave në vitet 2009 dhe 2010 për blerjen e tij duke përdorur si burim të financimit të tij, kursimet në *cash* që zotëronte subjekti i rivlerësimit deri në momentin e pagimit të gjithë çmimit të blerjes.

11.2 Në ankim, si dhe përgjatë gjykimit, Komisioneri Publik ka pretenduar se burimet që subjekti ka deklaruar se kanë shërbyer për blerjen e automjetit “Skoda Yeti”, së pari nuk lidhen me pakësimin e kursimeve në *cash*, dhe së dyti, të ardhurat e përfituara prej tij dhe bashkëshortes në fillim të vitit 2010, nuk mjaftojnë për të kryer pagesën e plotë të çmimit të këtij automjeti.

11.3 Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit në Komision, ashtu dhe në gjykim, ka shpjeguar se automjeti “Skoda Yeti” i blerë në shkurt 2010, është deklaruar në DVP-2009 (*para fillimit*) pasi të ardhurat e përdorura për blerjen e tij janë të ardhurat e fituara nga puna si avokat dhe si gjyqtar

³⁵ Rezultati prej 362.888 lekësh i analizës financiare të kryer në Kolegj, më datë 22.02.2015, ndryshon nga analiza e Komisionit në vlerën 423.638 lekë, në zërin e kostove të jetesës, në masën 16.020 lekë, si dhe nga disa pasaktësi në gjendjet e llogarive bankare në fund të vitit për llogarinë e personit të lidhur pranë Raiffeisen Bank, në masën 41.160 lekë.

dhe kurrresi blerja nuk është bërë me të ardhurat e përfituara nga 1 janari deri më 22 shkurt 2010, kur është lidhur kontrata e shitblerjes së këtij mjete.

11.4 Nga aktet e administruara, rezulton se subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën *vetting* si të blerë më datë 19.02.2010, nga shoqëria “{***}” ShPK, me vlerë: 14.500 euro, dhe burim të krijimit: **(i)** të ardhurat nga paga si avokat dhe gjyqtar; **(ii)** të ardhurat nga paga e bashkëshortes; **(iii)** 7.000 euro, përfituar nga shitja e mjetit “Mercedes Benz³⁶”, me targa {***}. *Pjesa takuese*: 50%, në bashkëpronësi të subjektit me bashkëshorten. Ndërsa subjekti ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën para fillimit të detyrës të dorëzuar më 19 mars 2010, si të blerë nga shoqëria “{***}” në vlerën prej 14.500 eurosh, por pa përcaktuar burimin e financimit të saj. Në të njëjtën deklaratë, subjekti ka deklaruar edhe shitjen e automjetit “Mercedes Benz” me targa {***}, në shumën prej 5.000 eurosh (në fakt, rezulton nga aktet e shitjes se vlera e shitjes ka qenë 7.000 euro, shifër që është saktësuar gjatë hetimit), duke pasqyruar në të, sipas konceptit të deklarimit para fillimit të detyrës, pasqyrimin e ndryshimeve në pasuritë e tij të ndodhura përgjatë periudhës që subjekti ishte larguar nga detyra e gjyqtarit dhe nuk kishte bërë deklarime për pasuritë. Pagesa e çmimit të blerjes së këtij automjeti rezulton të jetë kryer me dy këste, njëri në dhjetor të vitit 2009, prej 3.500 eurosh, dhe tjetri në ditën e finalizimit të kontratës, në shkurt të vitit 2010, në vlerën prej 11.000 eurosh.

11.5 Duke analizuar pretendimin e Komisionerit Publik lidhur me burimet e përdorura për blerjen e kësaj pasurie, Kolegji gjen të drejtë këtë pretendim për sa i përket faktit se Komisioni ka gabuar kur ka llogaritur si burim të krijimit të kësaj pasurie kursimet në *cash* të subjektit të zotëruara deri në shkurt të vitit 2010, duke qenë se nuk rezulton nga asnjë deklarim i subjektit që ai të ketë përdorur këto burime për të mundësuar financimin e kësaj pasurie. Në ndryshim nga kjo mënyrë e vlerësimit të burimeve të ligjshme, Kolegji, duke vlerësuar deklarimet e subjektit në deklaratën *vetting* dhe përcaktimin e burimeve të financimit sipas kësaj deklarate, e cila përbën edhe objektin e kontrollit të organeve të rivlerësimit sipas neneve 30, 32 e 33 të ligjit nr. 84/2016, deklarimet e tij në deklaratën e vitit 2010, të konceptuar si deklaratë para fillimit të detyrës, në të cilën referohet çdo e dhënë që ka ndryshuar nga dita e lënies së detyrës deri në ditën e përpilimit të deklaratës, në konsideratë edhe të arsytimit të bërë në paragrafët më sipër, arrin në konkluzionin se burimet që subjekti ka përdorur për të financuar blerjen e kësaj pasurie, janë të ardhurat e tij nga puna si avokat dhe gjyqtar, si edhe të bashkëshortes për periudhën qershor 2008 deri në ditën e përpilimit të kontratës së shitjes, datë 19.2.2010, përfshirë këtu edhe të ardhurat e përfituara prej shitjes së automjetit “Mercedes Benz” në vitin 2009.

11.6 Kolegji vlerëson se konsiderimi i këtyre burimeve si të përdorua prej subjektit për financimin e kësaj pasurie, është në harmoni me deklarimet e tij në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe me logjikën e pranuar se është përdorur prej tij, veçanërisht në deklarimin e bërë në vitin 2010, e cila konfirmon deklarimet e deklaratës *vetting* për burimin e krijimit. Duke përdorur këtë metodologji, Kolegji kreu analizën financiare për këtë periudhë, nga e cila rezultoi se subjekti kishte burime të ligjshme për të justifikuar pagimin e çmimit të kësaj pasurie në dhjetor 2009 dhe shkurt 2010³⁷.

³⁶ Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar që ky mjet është blerë prej tij dhe çmimi është paguar nga shtetasit K. dhe A. S. (me vlerë 2.800 euro), kushërinj të parë të subjektit, të cilët jetojnë e punojnë në Itali, ndërkohë që prej tij është paguar vetëm vlera e zhdoganimit të automjetit, në shumën 198.293 lekë.

³⁷ Situata financiare e subjektit për vitin 2009, duke konsideruar se për blerjen e autoveturës tip “Skoda Yeti” është kryer vetëm pagesa e kështit prej 3.500 eurosh, si dhe duke konsideruar që në analizë është përfshirë si e ardhur vetëm shuma prej 198.293 lekësh nga shitja e autoveturës së dhuruar prej kushërinjve (vetëm vlera e zhdoganimit), rezulton në diferencë pozitive prej (+) 1.385.726 lekësh. Në analizën financiare të Kolegjit për vitet 2008, 2009, deri më datë 19 shkurt 2010, janë përfshirë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga puna si avokat në masën 3.200.000 lekë, të ardhurat e vitit 2009 nga punësimi të konfirmuara nga Gjykata e Apelit Vlorë në masën 839.115 lekë, si dhe të ardhurat e përfituara deri më 19 shkurt 2010 e të konfirmuara nga *statement-i* i llogarisë së subjektit pranë Raiffeisen

Në të dhënat e llogaritura si të ardhura të subjektit, të përdorura për financimin e kësaj pasurie, Kolegji, ashtu si edhe Komisioni, ka llogaritur vetëm vlerën prej 198.293 lekësh, që vjen nga shitja e automjetit tip “Mercedes Benz” në vitin 2009 e që përfaqëson vlerën e zhdoganimit të këtij automjeti dhe nuk ka përfshirë në këtë analizë diferencën e çmimit të shitjes (7.000 euro – 198.293 lekë), për të cilën Komisioneri Publik pretendon se duhej të ishin paguar detyrimet tatimore që ajo të konsiderohej një pasuri e ligjshme. Në këto rrethana, Kolegji e konsideroi jorelevant trajtimin e çështjes së ligjshmërisë së kësaj vlere, duke qenë se ajo nuk luante një rol në përcaktimin e burimeve të ligjshme që ishin përdorur për blerjen e pasurisë automjet “Skoda Yeti”, të cilat rezultuan të mjaftueshme edhe pa përfshirë këtë vlerë.

11.7 Në përfundim të analizimit të këtij shkakui ankimi, Kolegji, pasi analizoi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, për burimet e krijimit të kësaj pasurie dhe deklaratimet e subjektit lidhur me këto burime, në deklaratën para fillimit të detyrës të datës 19.03.2010, arriti në konkluzionin se kjo pasuri është financuar me të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes, të krijuara gjatë gjithë periudhës maj 2008 deri në datën 11.02.2010, kur është formalizuar blerja e saj. Duke konsideruar këto të ardhura në analizën financiare të kryer në Kolegji për periudhën e sipërcituar, rezultoi se subjekti i rivlerësimit justifikoi me të ardhura të ligjshme financimin e kësaj pasurie, krahas shpenzimeve të tjera të kryera në këtë periudhë. Në këto kushte, Kolegji nuk konstatoi në lidhje me këtë pasuri, asnjë prej rasteve të parashikuara nga neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, e cila mund të përbënte një referim për deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë të subjektit të rivlerësimit.

12 Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik për pasurinë automjet tip “Fiat”, me targa {*}, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka pamjaftueshmëri financiare për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet e vitit 2006, përfshirë këtu dhe blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, shitja e të cilit ka shërbyer në vijim si një nga burimet e blerjes së automjetit “Fiat”, me targa {***}, analizojmë sa vijon.**

12.1 Referuar qëndrimit dhe analizës së Komisionit lidhur me këtë pasuri, është verifikuar mundësia e blerjes së këtij automjeti në vitin 2006 dhe ka rezultuar se subjekti ka pasur burime të mjaftueshme për ta justifikuar atë, por në ankim Komisioneri Publik ka konstatuar se Komisioni nuk ka përfshirë në analizë balancat negative të dy llogarive bankare, duke pretenduar se nëse këto llogari përfshiheshin, analiza e këtij viti del me rezultat negativ.

12.2 Subjekti ka prapësuar se, pavarësisht datës së kontratës të blerjes së automjetit që është në janar 2006, deklarimi i këtij automjeti në deklaratën e vitit 2005, është bërë pasi fondet e përdorura për blerjen e tij, janë krijuar përgjatë vitit 2005.

12.3 Lidhur me këtë çështje, Kolegji konstaton se subjekti ka deklaruar në deklaratën “vetting” pasurinë: automjet tip “Fiat”, me targa {***}, prodhim i vitit 2008, blerë në datën 30.09.2008, nga shoqëria “{***}” ShPK. Vlora: 8.800 euro, e financuar me burim të ardhurash të rrjedhura nga: të ardhurat nga paga e tij si avokat dhe gjyqtar; të ardhurat nga paga e bashkëshortes; dhe 500.000 lekë, përfituar nga shitja e mjetit “Mercedes Benz”, me targa {***}. Të njëjtin deklaram lidhur me

Bank, në masën 186.572 lekë. Analiza financiare e kryer në Kolegji për periudhën janar 2009 deri në 19 shkurt të vitit 2010, në të cilën blerja e automjetit tip “Skoda” është përballuar me të ardhurat e periudhës dhe pa përdorur cash-in e akumuluar nga subjekti në vitet më parë, rezulton në shifra pozitive në masën (+) 290.571 lekë. Nëse diferencës pozitive të analizës më datë 19 shkurt 2010, do t'i shtonim dhe diferencën pozitive të analizës ekonomike të vitit 2008 prej (+) 118.824 lekësh (e cila mund të konsiderohet si kursim), situata e përgjithshme financiare e subjektit të rivlerësimit do të rezultonte në masën (+) 409.394 lekë, e cila tregon që subjekti ka pasur mundësi të blinte makinën me të ardhurat e siguruara përgjatë viteve 2008-2009 - shkurt 2010 nga puna e tij.

këtë pasuri, ka kryer subjekti edhe në deklaratën e para fillimit të detyrës në vitin 2010, për blerjen e kësaj pasurie.

12.4 Duke verifikuar deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për një prej burimeve të përdorura për financimin e kësaj pasurie, në funksion të shqyrtimit të shkakat të ankimit të Komisionerit Publik, Kolegji konstaton se qoftë analiza e kryer nga Komisioni, qoftë ajo e propozuar nga Komisioneri Publik, nuk janë në koherencë me leximin dhe interpretimin e drejtë të deklaratimeve të subjektit dhe përcaktimit të vlerës provuese të deklaratave periodike, sipas asaj që parashikon neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

12.5 Në këtë vlerësim, Kolegji mban në konsideratë deklarinimin që subjekti ka bërë për fitimin e kësaj pasurie në deklaratën periodike të vitit 2005, pavarësisht faktit se kontrata është lidhur më 30 janar të vitit 2006. Duke iu referuar këtij deklarinimi, konstatohet se vetë subjekti, në kohën reale të përpilimit të deklaratës, e ka konceptuar dhe deklaruar këtë pasuri si një krijim të vitit 2005, me fondet financiare të krijuara në këtë vit. Duke përdorur këtë vlerësim, Kolegji kreu analizën financiare për të verifikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të përballuar me burime të ligjshme financimin e kësaj pasurie në vitin 2005, dhe nga kjo analizë, rezulton se subjekti kishte mundësi të justifikonte blerjen e kësaj pasurie me fondet e këtij viti³⁸. Në këtë kontekst, Kolegji nuk e pa të arsyeshme të analizojë aftësinë financiare të subjektit për vitin 2006 dhe të vlerësojë as ndikimin që mund të kenë në këtë analizë, lëvizjet e llogarive bankare të bashkëshortes së subjektit sipas pretendimit të Komisionerit Publik, duke qenë se kjo u konsiderua jorelevante në raport me analizën si më sipër.

12.6 Në përfundim të kësaj analize, Kolegji, pasi verifikoi mundësinë e subjektit të rivlerësimit për krijimin me burime të ligjshme të pasurisë automjet tip “Mercedez Benz”, me targa {***}, vlerën e përfituar nga shitja e së cilës subjekti e ka përdorur si një burim për financimin e pasurisë automjet tip “Fiat Panda”, në konsideratë të deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë të vitit 2005, vlerësoi se kjo pasuri është krijuar me të ardhurat e këtij viti, të cilat pasi iu nënshtruan analizës financiare të kryer, rezultuan të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie. Për pasojë, edhe të ardhurat e krijuara nga shitja e saj në vitin 2008, u konsideruan si të ligjshme dhe legjitimuan krijimin e pasurisë automjet tip “Fiat Panda”, duke e çuar Kolegjin në konkluzionin se për këtë pasuri nuk evidentohet asnjë prej rrethanave të parashikuara nga neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, e cila mund të përbënte një referim për deklarinim të pamjaftueshëm të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.

12.7 Në përfundim të vlerësimit të të gjitha shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, mbështetur në argumentet dhe qëndrimet e mbajtura në arsyetimin e mësipërm, Kolegji çmon se konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, është i mbështetur në fakte e në ligj.

³⁸ Analiza financiare e vitit 2005, e kryer nga Kolegji, rezulton në vlerë pozitive prej (+) 132.856 lekësh. Kjo analizë ndryshon me analizën e Komisionit, e cila ka rezultuar në shifra pozitive prej (+) 1.067.989 lekësh, për shkak të gjendjes së ndryshme të cash-it të konsideruar nga Kolegji prej 900.000 lekësh në total, përfshirjes së blerjes së autoveturës tip “Mercedes Benz”, me anë të kontratës së datës 30.01.2006, në masën 500.000 lekë, si dhe në mospërfshirjen e llogarisë bankare në emër të personit të lidhur në ABI Bank (NBG), në shumën 100 euro, me vlerë ekuivalente me 12.674 lekë, si dhe nga një pasaktësi në lidhje me gjendjen e llogarisë së personit të lidhur pranë Procredit Bank, më datë 31.12.2004, e cila konsiston në shumën 5.454 lekë dhe jo 3.261 lekë, e konsideruar në analizën ekonomike të Komisionit.

ii. Lidhur me shqyrtimin e denoncimeve të paraqitura në Kolegj

- 13 Në funksion të hetimit të denoncimit të paraqitur prej znj. S. Sh. dhe z. H. L., të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi, Kolegji vendosi kryerjen e disa veprimeve hetimore për të verifikuar vërtetësinë e informacionit të përcjellë nëpërmjet denoncimit që pretendonte për një pasuri të fshehtë të subjektit, e cila nuk ishte deklaruar në deklaratat periodike dhe as atë *vetting* e që konsistuan në: **(i)** marrjen prej shoqërisë “{***}” ShPK të informacionit përshkruar për marrëdhënien kontraktuale të pretenduar në denoncime, si dhe aktet shoqëruese përkatëse lidhur me kontratën me nr. {***} rep., datë 26.02.2014, dhe mandatarkëtimet nr. {***}, datë 26.02.2014, nr. {***}, datë 27.05.2014 dhe nr. {***}, datë 29.09.2014; **(ii)** marrjen prej shoqërisë “{***}” ShPK të informacionit nëse këto akte janë të përpiluara nga kjo shoqëri dhe nëse po, të përcjelljes së kopjes origjinale të këtyre akteve pranë Kolegjit; **(iii)** marrjen e informacionit mbi statusin aktual të pasurisë së përshkruar në kontratën nr. {***} rep., datë 26.02.2014, për sa i përket statusit të saj ligjor, gjendjes fizike dhe pronësinë mbi të; **(iv)** marrjen e informacionit prej Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Rajonale Vlorë, lidhur me pasurinë e përshkruar në kontratën nr. {***} rep., datë 26.02.2014, si dhe mbi objektin e ndërtuar në zbatim të lejes së ndërtimit të miratuar me vendim të KRRT-së Vlorë me nr. {***}, datë 24.02.2009, sipas akteve që iu bashkëngjiten dhe iu përcollën Agjencisë bashkë me kërkesën e trupit gjykues. Informacioni i kërkuar të merrej, duhej t’u referohej të dhënave që disponohen nga ish-zyra vendore e ALUIZNI-t dhe ish-Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë.

13.1 Në përgjigje të kërkesave procedurale për paraqitjen e akteve, Kolegji administroi shkresën e shoqërisë “{***}” ShPK³⁹, të nënshkruar nga administratori dhe njëkohësisht ortaku i vetëm i saj, F. K., tek e cila pasqyrohej informacioni se kontrata nr. {***} rep., datë 26.02.2014, ishte përpiluar nga kompania dhe ishte nënshkruar në zyrën e administratorit të saj, jo në prani të noterit, duke sqaruar gjithashtu se kjo kontratë ishte zgjidhur me marrëveshje të palëve, sipas deklaratës nr. {***} rep., datë 28.04.2015. për shkak të mospërbushjes së detyrimeve kontraktore prej blerësit (subjekti i rivlerësimit), lidhur me pagimin e këstit të radhës. Në shkresën e shoqërisë “{***}” ShPK, pasqyrohej gjithashtu se palët janë kthyer në gjendjen e mëparshme pasi kjo shoqëri i ka kthyer blerësit të gjithë vlerën e çmimit të paguar deri më datë 28.04.2015, me mandatpagesën nr. {***}, datë 28.04.2015 (kopje e së cilës ishte paraqitur bashkëlidhur përgjigjes së shoqërisë). Nga shkresa, por edhe nga përgjigja e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Rajonale Vlorë⁴⁰, konfirmohej fakti se pasuria e paluajtshme apartament, e përshkruar në kontratën e porosisë nr. {***} rep., datë 26.02.2014, aktualisht ishte në pronësi të shoqërisë “{***}” ShPK. Pavarësisht kërkesës së Kolegjit, bashkëlidhur përgjigjes së shoqërisë, mungonin ekzemplarët origjinalë të akteve të përmendura në denoncim.

13.2 Gjendur në kushtet në të cilat subjekti i rivlerësimit kontestoi përmbajtjen e denoncimeve, si dhe përgjigjen e shoqërisë “{***}” ShPK si të pavërtetë dhe aktet bashkëlidhur tyre si të falsifikuara dhe jo të nënshkruara prej tij, si edhe në konsideratë të faktit që në përgjigjen e saj kjo shoqëri nuk kishte paraqitur aktet origjinale të kontratës nr. {***} rep., datë 26.02.2014 dhe

³⁹ Të regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 16.07.2021.

⁴⁰ Shkresa nr. {***} prot., datë 22.07.2021.

mandatarkëtimet nr. {***}, datë 26.02.2014, nr. {***}, datë 27.05.2014 dhe nr. {***}, datë 29.09.2014, Kolegji, me qëllim hetimin e plotë të informacionit të përshkruar më lart, bazuar në përcaktimet e nenit Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 49, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, vendosi⁴¹ thirrjen në cilësinë e dëshmitarit të z. F. K., ortak i vetëm dhe administratori i shoqërisë “{***}” ShPK, si dhe urdhëroi atë të paraqesë pranë gjykatës ekzemplarët origjinalë të këtyre akteve.

13.3 Dëshmitari F. K. u paraqit para Kolegjit, i cili mori me cilësinë e provës, dëshminë e tij në seancë gjyqësore, me anë të së cilës ai mbështeti dhe konfirmoi të gjitha shpjegimet që kishte paraqitur edhe në shkresën drejtuar Kolegjit, duke dëshmuar si fakt të vërtetë lidhjen e kontratës së porosisë nr. {***} rep., datë 26.02.2014 dhe kryerjen e pagesave prej subjektit, me mandatarkëtimet nr. {***}, datë 26.02.2014, nr. {***}, datë 27.05.2014 dhe nr. {***}, datë 29.09.2014. Dëshmitari gjithashtu paraqiti para Kolegjit edhe ekzemplarët origjinalë të këtyre akteve, si dhe të deklaratës nr. {***} rep., datë 28.04.2015, me anë të së cilës palët revokonin këtë kontratë porosie, si dhe të mandatpagesës nr. {***}, datë 28.04.2015, me të cilën “{***}” ShPK i kishte kthyer mbrapsht subjektit të rivlerësimit pagesat e kryera deri në atë moment. Dëshmitari pretendoi prej trupit gjykues të Kolegjit, kthimin e ekzemplarëve origjinalë përgjatë së njëjtës seancë duke u shprehur se ai i solli për të provuar se ata ekzistojnë dhe se nuk mund t’i linte në dispozicion të trupit gjykues pasi ishin akte unike të vlefshme për shoqërinë e tij. Subjekti i rivlerësimit, edhe pas administrimit të akteve në formatin origjinal prej Kolegjit, pretendoi se ato akte ishin të rreme e të falsifikuara, të krijuara me qëllimin e vetëm për të ndikuar negativisht në procesin e tij të rivlerësimit dhe se Kolegji këto akte duhet t’ia nënshtronte ekspertimit grafik, për të provuar autenticitetin e tyre.

13.4 Ndodhur në kushtet kur njëra palë e procesit pretendonte falsitetin e akteve të paraqitura si provë e që kanë cilësitë e shkresës së thjeshtë sipas parashikimit të nenit 259 të Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues vendosi që bazuar në nenin 49, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 224/a të Kodit të Procedurës Civile, t’ia nënshtrorë këto akte ekspertimit grafik për t’iu përgjigjur pyetjes nëse ka elemente të falsitetit në aktet origjinale⁴² të depozituara nga dëshmitari F. K.. Kolegji vendosi që ekspertimi grafik të kryhej nga ekspertët e Institutit të Policisë Shkencore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

⁴¹ Me vendim të ndërmjetëm, të marrë në seancën gjyqësore të zhvilluar më datë 26.07.2021.

⁴² Aktet që iu nënshtruan ekspertimit grafik ishin:

- kontratë paraprake për shitje të pasurisë së paluajtshme me nr. {***} rep., datë 26.02.2014 - 4 (katër) fletë;
- mandati i arkëtimit nr. {***}, datë 26.02.2014 - 1 (një) fletë;
- mandati i arkëtimit nr. {***}, datë 27.05.2014 - 1 (një) fletë;
- mandati i arkëtimit nr. {***}, datë 29.09.2014 - 1 (një) fletë;
- deklaratë për revokim kontrate prenotimi me nr. {***} rep., datë 28.04.2015 - 1 (një) fletë;
- mandati i pagesës nr. {***}, datë 28.04.2015 - 1 (një) fletë.

Si modele krahasuese për kryerjen e aktit të ekspertimit, shërbyen modelet e lira të nënshkruara nga subjekti i rivlerësimit me dorë të lirë, në prezencë të trupit gjykues, në disa fletë format A4, si dhe deklaratat periodike të pasurisë në formatin origjinal të viteve 2013, 2014 dhe 2015, të marra për këtë qëllim nga ILDKPKI-ja, si dhe disa kopje të vendimeve në formatin origjinal, të nënshkruara nga subjekti i rivlerësimit në vitet 2014 dhe 2015.

13.5 Në zbatim të vendimit të Kolegjit, ekspertët⁴³ e Institutit të Policisë Shkencore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi kryen betimin sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile, morën detyrat e përcaktuara nga Kolegji për ekzaminimin grafik të dokumentacionit objekt ekspertimi të përshkruar më sipër, kryen ekspertimin grafik të kërkuar dhe paraqitën para trupit gjykues aktin e ekspertimit të hartuar prej tyre⁴⁴, për të cilin dhanë gjithashtu edhe shpjegime në seancë gjyqësore. Sipas konkluzionit të ekspertëve, të gjitha aktet objekt ekspertimi nuk ishin nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe ishin të falsifikuara.

13.6 Në përfundim, Kolegji pas kryerjes së një aktiviteti të plotë hetimor lidhur me të dhënat e denoncimeve të shtetasve S. Sh., H. L. dhe Q. H., si dhe pasi u njoh me konkluzionet e aktit të ekspertimit të ekspertëve të Institutit të Policisë Shkencore pranë Policisë së Shtetit, i cili konkludoi se të gjitha aktet e paraqitura në formatin origjinal nga dëshmitari F. K., si: kontratë porosie apartamenti, tri mandatarkëtime për pagime këstesh nga subjekti, deklaratë për revokimin e kontratës dhe mandatarkëtimi për kthim shume nga shoqëria, rezultuan jo të nënshkruara prej subjektit të rivlerësimit dhe të falsifikuara, i konsideroi këto denoncime si të pavërteta dhe, për pasojë, informacionin e pretenduar në to, si informacion që buronte nga dokumente të cilat u provuan në gjykim se ishin të falsifikuara, për pasojë ato nuk mund të përdreshin për të afektuar procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit në asnjë prej kritereve të këtij procesi.

13.7 Përveç konkluzioneve të mësipërme, në vlerësim të këtyre të dhënave, trupi gjykues çmoi se në veprimet e kryera nga shtetasi F. K., gjenden elemente të veprës penale të “Falsifikimit të dokumentit”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, të paktën me anë të përdorimit të tij, duke qenë se ishte pikërisht ky shtetas ai që i përdori këto akte nëpërmjet paraqitjes së tyre para trupit gjykues dhe se ai vetë mori përsipër autenticitetin e veprimeve të kryera, sipas deklarimit se aktet janë nënshkruar në prezencë të tij. Këto rrethana logjikshëm tregojnë se ai ka përgjegjësi, për sa rezulton nga të dhënat e administruara deri në këtë moment nga trupa gjyqësore, të paktën për përdorimin e këtyre dokumenteve të cilat u deklaruan të falsifikuara.

13.8 Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson se deklaratimet e shtetasit F. K. gjatë dëshmisë së dhënë prej tij, nën paralajmërimin e nenit 237 të Kodit të Procedurës Civile, për të deklaruar të vërtetën dhe vetëm të vërtetën, në raport me konkluzionet e mësipërme se aktet të cilat u deklaruan prej tij se janë nënshkruar prej subjektit Sokol Ngresi në prezencë të tij, rezultuan të falsifikuara, sjellin njoftime për kryerjen e një vepre tjetër penale, që është ajo e “Dëshmisë së rreme”, parashikuar nga neni 306 i Kodit Penal.

13.9 Në këto kushte, mbështetur në detyrimin ligjor që vjen nga parashikimi i nenit 281, paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale dhe neneve 245 e 271 të Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues vendosi të depozitohet⁴⁵ në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, kallëzimin penal me qëllim ushtrimin e ndjekjes penale ndaj shtetasit F. K., për veprat penale të “Falsifikimit të

⁴³ Z. Sh. Xh. dhe z. D. Ç.

⁴⁴ Akti i ekspertimit mban nr. {***}, i datës 03.11.2021, i cili është përcjellë në Kolegj me shkresën nr. {***} prot., datë 04.11.2021, të Institutit të Policisë Shkencore.

dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal dhe “Dëshmisë së rreme”, parashikuar nga neni 306 i Kodit Penal.

- 14 Në përfundim të sa më sipër, pas shqyrtimit të të gjitha shkaqeve të ankimit dhe hetimit të plotë të denoncimit, Kolegji arriti në përfundimin se qëndrimi i Komisionit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 59, pika 1, germa “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, është i mbështetur në një vlerësim të drejtë të fakteve që kanë rezultuar nga hetimi dhe në legjislacionin e zbatueshëm.
- 15 Në këto kushte, Kolegji çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 324, datë 11.12.2020, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Sokol Ngresi, është i drejtë dhe i bazuar në ligj, për pasojë ai duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 324, datë 11.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Sokol Ngresi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 24.11.2021.

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi